



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË
INSPEKTORATI**

TIRANË, 24 MARS 2015

RAPORT VJETOR

MBI

VEPRIMTARINË E INSPEKTORATIT

TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PËR VITIN KALENDARIK 2014

Përgatitur nga:

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë
Kryeinspektore Marsida Xhaferllari

○ PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (IKLD) është një strukturë shtetërore, e ngritur me ligj në vitin 1999, që funksionon në varësi të drejtpërdrejtë të KLD-së. Me ligj, IKLD-së i është ngarkuar përgjegjësia e monitorimit të performancës së sistemit gjyqësor nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve, verifikimit të ankesave dhe vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve. Veprimtaria e IKLD-së i shërben KLD-së për të ushtruar funksionet kushtetuese të kontrollit dhe të rritjes në karrierë të gjyqtarëve. Organizimi dhe funksionimi i tij rregullohet përmes dy ligjeve organike mbi pushtetin gjyqësor dhe mbi KLD-në.

IKLD, nëpërmjet Kryeinspektore, paraqet këtë raport vjetor me shkrim pranë KLD-së bazuar në nenin 55 të Rregullores së IKLD-së. Ky raport përmban të dhëna mbi veprimtarinë e IKLD-së në vitin kalendarik 2014 dhe në të gjejnë pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës.

Në Raportin Vjetor 2014 përshkruhet gjendja e burimeve njerëzore dhe statusi i inspektorëve, për të vijuar me masën e realizimit të detyrave funksionale, siç evidentimi i rasteve për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve (verifikimi i ankesave, raportimi periodik i gjyqtarëve, inspektimi tematik, përpunimi administrativ i vendimeve të cenuara) dhe vlerësimi profesional dhe etik i gjyqtarëve. Gjithashtu, në të janë përshkruar edhe proceset e tjera në të cilat është angazhuar Inspektorat, siç janë përpunimi i kërkesave për delegim të gjyqtarëve, përfaqësimi i KLD-së në gjykatë në çështjet gjyqësore deri tek marrëdhëniet institucionale me organet e treta. Paraqitja e informacionit është shoqëruar edhe me identifikimin e problematikave dhe dhënien e sugjerimeve modeste për zgjidhjen e tyre. Siç përshkruhet edhe në brendësi të këtij Raporti, volumi i punës për vitin 2014 ka patur rritje në raport me me vitin 2013 në të gjithë treguesit.

Tashmë, Inspektorati prej 2 vjetësh po krijon traditën institucionale të analizës së përgjithshme të veprimtarisë, me objektivin e krijimit të të dhënave solide mbi rezultatet e punës, problematikat dhe përcaktimin e prioritetëve për të ardhmen. Ky është viti i dytë radhazi, me të cilin procedohet me hartimin dhe paraqitjen e Raportit Vjetor të Inspektoratit, pasi në të kaluarën një traditë e tillë ka munguar. Aktivizimi i këtij instrumenti ka disa avantazhe. Ai i shërben analizës së gjendjes aktuale të IKLD-së, krijimit të të dhënave solide dhe analizës krahasimore të tyre, si dhe përcaktimit të prioritetëve të veprimtarisë së tij në drejtim të efikasitetit dhe profesionalizmit në detyrë.

I. BURIMET NJERËZORE DHE ORGANIZIMI

Në zbatim të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar, KLD ka miratuar në vitin 2006 Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e IKLD-së. Kjo Rregullore lejon mundësinë e organizimit të Inspektoratit në seksione. Me vendimin nr. 302/2, datë 20.12.2012 të KLD-së, Inspektorati u organizua për herë të parë në dy seksione: atë të vlerësimit profesional dhe etik dhe në seksionin e ankesave dhe të inspektimit. Me të njëjtin vendim, u përcaktua që organika e Inspektoratit të rritet në 1 Kryeinspektor dhe 15 inspektorë, të cilët në veprimtarinë administrative mbështeten edhe nga administrata e KLD-së. Kjo strukturë vijoi pa ndryshime edhe përgjatë vitit kalendarik 2014.

Në IKLD ushtrojnë funksionin e tyre Marsida Xhaferllari (kryeinspektore), Izet Salaj (inspektor), Qemal Zaimi (inspektor), Hajrie Muçmata (inspektore), Piro Samara (inspektor), Arjan Qafa (inspektor), Fatbardh Çoniku (inspektor), Zhaneta Pira (inspektore), Dashuri Gjunksi (inspektore), Sofie Zhilla (inspektore), Vojsava Osmanaj (inspektore), Marsela Pepi (inspektore) dhe Kujtim Vraniçi (inspektor). Gjatë vitit kalendarik 2014 ka filluar mandatin e tij vetëm inspektori Kujtim Vraniçi, ndërsa 3 inspektorët Izet Salaj, Hajrie Muçmata dhe Piro Samara kanë mbushur periudhën 5 vjeçare të mandatit dhe mbeten në pritje të vendimmarrjes së KLD-së. Aktualisht ka 3 vende vakante në IKLD (20 % e numrit të përgjithshëm të inspektorëve) dhe këto mungesa kanë dhënë ndikim në volumin dhe shpejtësinë e përmbushjes së detyrave në IKLD.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se Inspektorati nuk ka në strukturën e tij të brendshme specialistë me status të nëpunësit civil, por mbështetet nga jashtë nga Sektori Juridik i Drejtorisë Juridike. Mungesa e raporteve hierarkike të drejtpërdrejta evidenton disa vështirësi të ndërsjella specialist-inspektor, që reflekton tek cilësia e punës. Gjatë vitit 2014 ka patur lëvizje të punonjësve edhe në Sektorin Juridik, lëvizje të cilat kanë vështirësuar proceset administrative të punës sepse lidhen me kohën që i nevojitet punonjësve të rinj të përshtaten me kriteret e vendit të punës.

Situata e organizimit dhe funksionimit të IKLD është marrë shpesh në analizë nga grupe të brendshme pune apo edhe nga ekspertë ndërkombëtarë¹, të cilët bashkohen në përfundimin se ka vend për përmirësimin e ndjeshëm të statusit të inspektorëve (rekrutimi, trajnimi, promovimi, përgjegjësia disiplinore, garancitë në detyrë, paga dhe përfitimet sociale deri tek kushtet dinjitoze të punës). Përmirësimi i statusit të inspektorëve mendohet të rrisë kërkesat e gjyqtarëve dhe të profesionistëve të spikatur për të shërbyer në IKLD dhe rrjedhimisht të përmirësojë performancën e kësaj strukture.

Një hap pozitiv i vitit kalendarik 2014 ka qenë ngritja e Grupit të Punës për hartimin e Skemës së Vlerësimit të Inspektorëve për të reflektuar ndryshimet ligjore të ligjit organik të KLD-së². KLD me vendimin nr. 133, datë 17.10.2014 ngriti një Grup Pune të përbërë nga tre anëtarët Flamur

¹ *Shih* Projekt Politikën Për Reformimin e Inspektoratit të KLD-së, Raportin e Fillimit të Projektit të Misionit Euralius IV për periudhën 01.09.2014-30.11.2014 dhe Relacionin Shpjegues të Grupit të Punës për Skemën e Vlerësimit të Inspektorëve

² Me ndryshimet e prezantuara me ligjin nr. 101, datë 31.07.2014, neni 14 pika 6 e ligjit nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar, parashikon “Për kryeinpektorin dhe inspektorët, jo më pak se një herë në 2 vjet, kryhet vlerësimi profesional dhe etik sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë”

Kapllani, Dritan Caka dhe Sokol Çomo. Grupi i punës u asistua nga kryeinspektorja Marsida Xhaferllari, inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Marsela Pepi, Drejtori Juridik Vildan Kaloshi, si dhe nga dy ekspertë të Misionit Euralius IV Agnes Bernhard dhe Erton Karagjozi. Grupi i Punës zhvilloi një skemë vlerësimi profesional dhe etik të inspektorëve, përmes identifikimit të problematikave aktuale, me vizionin e kthimit të Inspektoratit në një strukturë eficiente dhe profesionale në përmbushjen e funksionit për monitorimin e performancës së gjyqtarëve. Është e pritshme që KLD të miratojë Skemën e Vlerësimit së shpejti, duke i hapur rrugë në këtë mënyrë, zhvillimit të karrierës së inspektorëve bazuar në meritat profesionale dhe integritetin.

Siç është bërë me dije edhe në Raportin Vjetor të vitit 2013, mungojnë rregullat për trajnimin fillestar dhe trajnimin vazhdues të inspektorëve, që është me ndikim në cilësinë e punës së tyre. Një inspektor i rekrutuar për herë të parë ka nevojë të kuptojë thelbin e punës së inspektorit, ndërsa inspektorët në detyrë kanë nevojë për të përditësuar njohuritë e tyre mbi zhvillimet legislative të shpeshta dhe doktrinare. Pavarësisht mungesës së infrastrukturës ligjore të përshtatshme, IKLD është asistuar gjatë vitit kalendarik 2014 në drejtim të trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe nga organizatat ndërkombëtare dhe vendase. Gjatë vitit 2014, inspektorët e IKLD kanë marrë pjesë për shkak detyre në 10 trajnime profesionale, si më poshtë:

- i) Trajnimi “Etika gjyqësore” më 9-11 Prill 2014, i organizuar nga Misioni OPDAT dhe Ambasada Britanike, ku morën pjesë të gjithë inspektorët e KLD-së, në mënyrë të alternuar.
- ii) Trajnimi “Zvarritja e gjykimeve dhe projekti për një drejtësi pa vonesa” më 14.10.2014, i organizuar nga JuST USAID dhe OSBE, ku morën pjesë të gjithë kryeinspektorja dhe të gjithë inspektorët e KLD-së.
- iii) Trajnimi “Përdorimi i Sistemit të Regjistrimit Dixhital Audio në gjykata” në 7-11 korrik 2014, i organizuar nga JuST USAID, ku morën pjesë kanë marrë pjesë kryeinspektorja dhe të gjithë inspektorët në mënyrë të alternuar.
- iv) Trajnimi “Inspektimi i rasteve të shkeljes së etikës gjyqësore” më 9-11 korrik 2014, i organizuar nga Ambasada Franceze dhe Misioni OPDAT, ku morën pjesë kryeinspektorja dhe të gjithë inspektorët.
- v) Trajnimi “Mbështetje për efikasitetin në drejtësi me fokus statistikat” më 3-4 nëntor 2014, i organizuar nga SEJ, Këshilli i Evropës, ku morën pjesë kryeinspektorja Marsida Xhaferllari dhe inspektorja Marsela Pepi.
- vi) Trajnimi “Lufta kundër terrorizmit, standardet e Bashkimit Europian, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe eksperiencat e vendeve anëtare” më 27-28 janar 2014, i organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe TAIEX, ku morën pjesë inspektorët Marsela Pepi dhe Izet Salaj.
- vii) Trajnimi “Zgjidhja e konflikteve dhe pajtimi i mosmarrëveshjeve” më 23-24 qershor 2014, i organizuar nga Fondacioni Slynn dhe Fondacioni i Zgjidhjes Jashtëgjyqësisht të Mosmarrëveshjeve, ku morën pjesë inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Marsela Pepi.
- viii) Trajnimi “Veprat penale dhe llojet e saj” më 8 Maj 2014, i organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, ku mori pjesë inspektorja Sofie Zhilla.
- ix) Trajnimi “Provat e marra në kundërshtim me ligjin, papërdorshmëria. Pavlefshmëria e akteve procedural” më 20-21 Maj 2014, i organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, ku mori pjesë inspektorja Sofia Zhilla.
- x) Trajnimi “Kontratat e sipërmarrjeve në fushën e ndërtimeve” më 25-26 Qershor 2014, i

organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, ku mori pjesë inspektorja Sofia Zhilla.

Gjithashtu, kryeinspektorja dhe inspektorët janë angazhuar edhe në grupe pune profesionale, si më poshtë

- i. Grupi i Punës i ngritur në KLD me objekt “Hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve në KLD për vitin 2014”, ku ka marrë pjesë inspektorja Vojsava Osmanaj. Produkti i këtij grupi pune u finalizua si masë e përfshirë në dokumentet strategjike me fokus integrimin evropian dhe u publikua në faqen zyrtare të KLD-së³.
- ii. Grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 29, datë 14.01.2014 të Ministrit të Drejtësisë “Për ngritjen e Komitetit Drejtues për rishikimin e projektit për ndërtimin e pallatit të drejtësisë në kuadër të Programit IPA 2012”, në të cilin ka marrë pjesë inspektorja Vojsava Osmanaj.
- iii. Takimet e Këshillit Drejtues për të lehtësuar zbatimin e projektit “Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë SEJ”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Në këto takime, kanë marrë pjesë në mënyrë të alternuar kryeinspektorja dhe inspektorja Marsela Pepi. Fokusi i këtyre mbledhjeve kanë qenë përzgjedhja e 10 gjykatave pilot, konsultimi mbi termat e referencës, konsultimi mbi sondazhet dhe mbi hartimin e raporteve të ekspertëve të projektit⁴.
- iv. Grupi i punës mbi “Hartimin e Skemës së Vlerësimit të Inspektorëve”, i ngritur me vendimin nr. 133, datë 17.10.2014, në të cilin kanë marrë pjesë edhe kryeinspektorja Marsida Xhaferllari dhe inspektorët Marsela Pepi dhe Vojsava Osmanaj. Produkti i këtij grupi pune është shqyrtuar në mbledhjen e datës 03.03.2015 të KLD-së dhe është e pritshme, që pas reflektimit të komenteve të anëtarëve, të miratohet në një mbledhje të afërt të KLD-së.
- v. Grupi i punës i ngritur nga ENCJ (Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë) i financuar nga Bashkimi Evropian, i ngarkuar me detyrën e hartimit të standardeve minimale evropiane për procedimin disiplinor të gjyqtarëve. Në këtë grup pune, për shkak të nevojës së gjuhës angleze, kanë marrë pjesë kryeinspektorja dhe inspektorja Vojsava Osmanaj.
- vi. Grupi i punës për hartimin e projektligjit “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve në RSh”, i ngritur nga Ministria e Drejtësisë dhe Misioni Euralius, në të cilin ka marrë pjesë kryeinspektorja. Aktualisht, është përfunduar drafti i parë i projektligjit dhe ka filluar procedura e konsultimit zyrtar të jashtëm të tij.
- vii. Grupi i punës “Për kryerjen e një studimi vlerësues mbi ngarkesën e punës në Gjykatën Administrative të Apelit”, i ngritur nga KLD me vendimin nr. 149, datë 05.12.2014, në të cilin ka marrë pjesë kryeinspektorja. Studimi u shqyrtua dhe u miratua në mbledhjen plenare të datës 03.03.2015 të KLD-së. Ai është publikuar edhe në faqen zyrtare të KLD-së⁵.

Me ligjin nr. 114/2013, datë 11.04.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008

³ Shih <http://kld.al/njoftime/plani-i-trajnimeve-2014>

⁴ Të dhënat mbi këtë projekt mund të konsultohen në <http://www.coe.int/en/ëeb/tirana/eu/coe-support-to-efficiency-of-justice>

⁵ Shih <http://kld.al/korniza-ligjore/akte-n%C3%ABnligjore/studimi-mbi-ngarkesen-ne-gjykatën-administrative-te-apelit>

‘Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh’’, paga e inspektorit u rrit me 3.6 % në raport me pagën e mëparshme (nga 70 % e pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në 75 %). Kjo rritje e pagës u bë efektive më 01.01.2014.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, është e përshtatshme të analizohet me kujdes natyra e punës në IKLD me qëllim përcaktimin e kriterëve të qarta, procedurave efektive dhe një skeme garantiste në drejtim të statusit për inspektorët. Natyra delikate e punës së inspektimit kërkon një vëmendje dhe mbrojtje të posaçme shtetërore për zyrtarët që përmbushin me profesionalizëm dhe integritet këtë detyrë të vështirë.

Së fundmi, duhet që proceset e punës në Inspektorat të dixhitalizohen për të lehtësuar krijimin e regjistrave solidë të të dhënave mbi ankesat e paraqitura, mbi vlerësimet e kryera dhe mbi inspektimet e zhvilluara. Mbajtja solide e këtyre të dhënave i shërben krijimit të një historie institucionale të shëndetshme, analizimit të të dhënave dhe formulimit të politikave të përshtatshme.

II. EVIDENTIMI I RASTEVE PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE

Inspektorati edhe gjatë vitit 2014 është angazhuar për evidentimin e rasteve për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të dytë. Në kryerjen e kësaj detyre janë kryer proceset e verifikimit të ankesave, të verifikimit të raportimeve të kryera nga kryetarët e gjykatave, të inspektimit tematik të urdhëruar nga KLD dhe të përpunimit administrativ të vendimeve të cenuara. Analiza e të dhënave të këtyre proceseve nxjerrin në pah një volum të shtuar pune, të cilin Inspektorati është angazhuar ta përfundojë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të standardeve të vendosura në funksion të forcimit të sistemit disiplinor të gjyqtarëve. Në përmbushjen e këtij funksioni, është vepruar duke mbajtur në konsideratë konkluzionin e Komisionit Evropian në Raportin e Progresit për Shqipërinë 2014⁶, sipas të cilit “sistemi disiplinor për magjistratët ka nevojë të forcohet në mënyrë thelbësore”. Proceset e punës të kryera nga IKLD në drejtim të evidentimit të rasteve për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, përshkruhen më poshtë.

1. Verifikimi i ankesave

Një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të Inspektoriatit është verifikimi i ankesave, të cilat mund të paraqiten nga qytetarët ose çdo subjekt i interesuar. Rregullat e brendshme⁷ vendosin si kusht të domosdoshëm paraqitjen e një ankesë formale me shkrim, e cila duhet të plotësojë disa elementë të domosdoshëm.

Rezultatet e këtyre ankesave i nënshtrohen vlerësimit paraprak, i cili mund të konkludojë me arkivimin e ankesës nëse shkaqet janë haptazi të pabazuara ose me verifikimin në terren të ankesës, nëse ka dyshime për shkelje ligjore formale. Aktualisht, rregullat janë të paqarta mbi burimin e sigurimit të provave/të dhënave në fazën e vlerësimit paraprak, si dhe në fazën e verifikimit në themel të ankesës. Gjithashtu, rregullat për arkivimin e ankesës mbi një shqyrtim *prima facia* nga Inspektorati janë të paplota dhe për pasojë inspektorët shpesh janë në pamundësi për të identifikuar saktë konkluzionet në fazën e vlerësimit paraprak.

Nëse gjatë verifikimit në terren të ankesave, Inspektorati konstaton shkelje në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarëve, atëherë ka bazë për zhvillimin e dy procedurave. Nëse shkeljet janë të lehta dhe të papërshtatshme për fillimin e një procedimi disiplinor, gjyqtarit i regjistrohen të dhënat për vlerësimin profesional ose i tërhiqet vëmendja me shkrim për to. Nëse shkeljet janë të afta për të filluar një procedim disiplinor, atëherë të gjitha materialet i dërgohen zyrtarisht Ministrisë të Drejtësisë, që ai të vlerësojë mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor të gjyqtarëve.

Edhe gjatë vitit 2014, ka vijuar e njëjta problematikë, si ajo e raportuar për vitin 2013. Vijon të jetë prezente **problematika e përmirësimit të rregullores së brendshme** të Inspektoratit në dy drejtime: (i) përmirësimi i procesit për ta përputhur atë tërësisht me kërkesat e procesit të rregullt ligjor, sidomos në drejtim të garancive të gjyqtarit në verifikim për t’u njohur dhe për të

⁶ *Shih* Raportin e Progresit për Shqipërinë, faqe 40

⁷ *Shih* Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”, e miratuar me vendimin nr. 195/2/a, datë 05.07.2006, i ndryshuar

prapësuar gjetjet e verifikimit; (ii) përjasja e rregullave të Inspektoratit, të miratuara në vitin 2006 me rregullimet ligjore në fuqi, të miratuara në vitin 2008. Ligji i vitit 2008, bazuar në parimin e ligjshmërisë ka përcaktuar hipoteza të shprehura për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit, të cilat mungojnë në rregullore. Këto hipoteza lidhen me shkeljen e qëllimshme ose shkeljen e përsëritur të dispozitave urdhëruese procedurale nga ana e gjyqtarit. Në disa raste ka edhe mospërputhje të hipotezave përgjegjësi disiplinore me kufijtë e veprimit nga Inspektorati, siç është rasti i mosbërjes së kërkesës së gjyqtarit për përjashtim nga një çështje konkrete.


Përmirësimi i rregullave të verifikimit të ankesave është me rëndësi thelbësore sepse jo vetëm që forcon mundësinë e monitorimit të sistemit, por siguron edhe një bazë shumë të mirë të dhënash për analiza të mëtejshme. Ato duhet të shërbejnë për të nxitur proceset e inspektimeve njohëse tematike dhe territoriale në gjykata. Inspektorati ka filluar të ndërtojë traditën e programimit paraprak të inspektimeve dhe traditën e raportimit periodik të Kryeinspektorese përpara KLD-së mbi veprimtarinë e zhvilluar nga Inspektorati. Aktivizimi i këtyre instrumenteve i jep jetë edhe edhe përpunimit të rekomandimeve të përshtatshme për të ardhmen.

Sipas nenit 25 pika 4 të Rregullores së IKLD-së, ankesat e depozituara, si dhe ato të bëra publike nëpërmjet mediave, regjistrohen në **Regjistrin e Ankesave**, për të cilin është ngarkuar posaçërisht specialistja Ronida Trupi. Për çdo ankesë, Regjistri tregon këto të dhëna: identiteti i ankuesit, gjyqtari dhe gjykata ndaj të cilit adresohet ankesa, lënda e ankesës dhe shkelja e pretenduar, data e urdhrin të verifikimit, inspektori i ngarkuar për verifikim, datat e veprimeve të inspektorit dhe mënyra e përfundimit të verifikimit të ankesës. Në shtesë të këtyre elementëve të domosdoshëm të kërkuara nga Rregullorja, në vitin 2014 Regjistri i Ankesave është pasuruar me rubrika që identifikojnë saktë përmbajtjen e ankesave (etikë dhe korrupsion, zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal ligji) si dhe me rubrikat për mënyrën përfundimtare të verifikimit (pa shkelje, vlerësim profesional, rekomandim për gjykatat, tërheqje vëmendje apo procedim disiplinor). Shtimi i këtyre rubrikave i shërben lehtësimin të mbledhjes dhe përpunimit të statistikave. Vijon të mbetet shqetësues fakti se Regjistri i Ankesave mbahet në mënyrë manuale, që krijon vështirësi për administrimin e të dhënave, si dhe për përpunimin analitik të të stastikave. Është përpunuar një formë elektronike e tij, por është në nivel primitiv pasi i referohet formatit Microsoft Excel.

Përgjatë periudhës 01.01.2014 - 31.12.2014 numri i ankesave të paraqitura është 883, nga të cilat 855 ankesa janë paraqitur nëpërmjet shërbimit postar apo fizikisht nga ankuesit, ndërsa 28 ankesa janë paraqitur nëpërmjet postës elektronike. Në raport me numrin e ankesave të paraqitura në vitin 2013 – gjithsej 883 ankesa, konstatohet që nuk ka ndryshim në fluksin e tyre.

Pas shqyrtimit paraprak të 883 ankesave të paraqitura, **207 prej tyre janë verifikuar (23.4 %), ndërsa 676 ankesa janë arkivuar.** Duhet evidentuar se në çdo rast, për çdo vendim të ndërmjetëm apo përfundimtar të IKLD-së mbi ankesat (arkivimin e ankesës, fillimin e verifikimit, verifikimin në vijim apo rezultatet përfundimtare të verifikimit), ankuesi njoftohet me shkrim. Aktet e njoftimit janë përpiluar nga administrata e KLD-së (Sektori Juridik dhe i Dokumentacionit të Drejtorisë Juridike), të cilët kanë mbështetur vijimësisht IKLD-në në kryerjen e funksioneve.

Ankesat e paraqitura



Inspektorët kanë marrë pjesë në të dyja fazat e shqyrtimit administrativ të ankesave (shqyrtimin paraprak dhe verifikimin e tyre). Aktet e relatimit të ankesave janë tashmë të standardizuara dhe kontrollohen për saktësinë e tyre nga kryeinspektorja Marsida Xhaferllari. Duhet theksuar se në verifikimin e ankesave, bazuar në standardet e Manualit të Verifikimit, në çdo rast janë caktuar 2 inspektorë. Të dhënat individuale për shqyrtimin administrativ të ankesave nga inspektorët, sipas rendit alfabetik me bazë emrin, jepen në tabelën e mëposhtme. Inspektorët Izet Salaj, Marsela Pepi dhe Qemal Zaimi janë angazhuar përgjatë gjithë vitit 2014 në verifikimin e ankesave, ndërsa inspektorët e tjerë, sipas fluksit të paraqitjes së dokumentacionit nga kryetarët e gjykatave, janë angazhuar në vlerësimin profesional të gjyqtarëve, për t'iu përgjigjur prioritetit të vendosur nga KLD.

Nr.	Kryeinspektori/Inspektori	Shqyrtim paraprak	Verifikime
1.	Arjan Qafa	25	13
2.	Dashuri Gjunksi	19	2
3.	Fatbardh Çoniku	17	9
4.	Hajrie Muçmata	29	9
5.	Izet Salaj	167	116
6.	Marsela Pepi	209	94
7.	Piro Samara	10	20
8.	Qemal Zaimi	204	78
9.	Sofie Zhilla	5	9
10.	Vojsava Osmanaj	21	6
11.	Zhaneta Pira	95	3
12.	Kujtim Vraniçi	82	55

○ Ankesa të verifikuara

Në 207 ankesa të verifikuara nga Inspektorati, shkaqet e verifikimit lidhen me: (i) zvarritjen e gjykimit në 122 raste; (ii) mosrespektimin formal të ligjit në 58 raste; dhe (iii) shkelje etike në 27 raste. Nga verifikimi i 207 ankesave të paraqitura ka rezultuar se në 73 prej tyre janë konstatuar shkelje në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit. Ankesat e gjetura me shkelje zënë 35.2 % të numrit të ankesave të verifikuara, megjithatë tek ky tregues duhet mbajtur në konsideratë fakti se 45 ankesa të verifikuara janë në proces verifikimi në vijim, në pritje të vendimmarrjes së gjykatave më të larta, ndërsa 27 ankesa të tjera janë në proces të verifikimit fillestar.

Në raport me shkeljen e identifikuar në **verifikimin e 73 ankesave** është vepruar si më poshtë:

- i. Në mbështetje të materialeve të verifikimit të 3 ankesave, materialet i janë përcjellë Ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor, si i vetmi organ i cili mund të iniciojë procedimin disiplinor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Një prej ankesave lidhet me mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe ky rast është paraqitur nga Ministri i Drejtësisë në KLD, i cili ka kërkuar masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarit. Një ankesë tjetër lidhet për zvarritje dhe Ministri i Drejtësisë ka paraqitur kërkesën në KLD, duke kërkuar masën “shkarkim nga detyra” të gjyqtarit. Rasti i tretë lidhet sërish me zvarritje gjykim. Të treja rastet janë për gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë;
- ii. Në mbështetje të materialeve të verifikimit të 21 ankesave, është proceduar me tërheqje vëmendje për gjyqtarin/gjyqtarët e kontrolluar bazuar në nenin 34 pika 2 të Rregullores. Shkelja dominante e konstatuar në këto raste ka qenë organizimi i dobët i punës me pasojë zvarritjen e gjykimit, shkelja e afateve procedurale të caktuara nga ligji apo shkelja e dispozitave të tjera urdhëruese për herë të parë nga gjyqtari. Shkaqet e këtyre 21 rasteve janë: (i) me zvarritjen e gjykimit 13 raste; (ii) me mosrespektimin formal të ligjit 3 raste; dhe (iii) me shkeljen e etikës 5 raste;
- iii. Në mbështetje të materialeve të verifikimit të 48 ankesave, janë evidentuar shkelje shumë të lehta, të cilat janë regjistruar për efekte të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarit të kontrolluar. Natyra e këtyre shkeljeve lidhet me tejkalimin e afateve standard të gjykimit të caktuara nga KLD për efekte të vlerësimit profesional apo me cenimin e vendimeve nga gjykatat më të larta.
- iv. Në 4 raste, janë lëshuar edhe rekomandime për gjykatat. Një rekomandim i është drejtuar Gjykatës së Apelit për ndryshimin e praktikës gjyqësore në procedurën e heqjes dorë të gjyqtarit dhe ndalimin e tij për kryerjen e veprimeve procedurale të mëtejshme me çështjen; dy rekomandime i janë dërguar gjykatave pas shqetësimit të ngritur nga Ambasada Britanike për zbatimin e marrëveshjes dypalëshe për transferimin e personave të dënuar; dhe një rekomandim i është drejtuar kryetarit të gjykatës së shkallës së parë për të shfuqizuar urdhrin për mënyrën e pagesës së vlerës së padisë.

Në 63 raste ankesash, nga verifikimi është konstatuar se gjyqtarët e kontrolluar nuk kanë patur shkelje; në 45 ankesa janë në proces verifikimi në vijim deri në përfundim të procesit gjyqësor me një vendim përfundimtar nga shkallët më të larta; ndërsa 27 ankesa të tjera janë ende në proces verifikimi.


Në ankesat e verifikuara, 27 prej tyre kanë patur për objekt **shkeljen e rregullave të etikës** nga gjyqtarët. Edhe përgjatë vitit 2014, ka vijuar vështirësia e verifikimit të këtyre rasteve për shkak të nivelit të ulët bashkëpunues të individëve të pranishëm kur ka ndodhur shkelja dhe nevojiten teknika dhe aftësi të specializuara të inspektorëve në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2014, Inspektorati i ka përcjellë 5 raste Komisionit të Etikës të Konferencës Gjyqësore

Kombëtare, i cili përbëhet vetëm nga gjyqtarë të të gjitha niveleve, për marrje mendimi këshillimor, nëse sjellja e konstatuar ka qenë në përputhje me rregullat e Kodit të Etikës. Në çdo rast të referuar, Komisioni i Etikës është përgjigjur me opinion këshillimor me shkrim të arsyetuar. Ky lloj bashkëpunimi institucional është shumë i vlefshëm sepse i shërben qasjes proaktive dhe të shumëfishtë institucionale në parandalimin e sjelljeve që cenojnë integritetin e gjyqtarëve. Nga ana tjetër, ky bashkëpunim rrit në mënyrë të ndjeshme reagimin nga radhët brenda gjyqësorit.

Nga ana tjetër, për të përmirësuar cilësinë e verifikimit të rasteve të etikës, me asistencën e Ambasadës Franceze dhe të Misionit OPDAT, u organizua një trajnim 3 ditor me temë “Inspektimi i rasteve të shkeljes së etikës gjyqësore” më 9-11 korrik 2014. Çështjet e trajtuara në trajnim përfshinë standardet e sjelljes gjyqësore në SHBA, në Francë dhe në Shqipëri, mekanizmat e disiplinës për sjelljen e papërshtatshme gjyqësore, marrja e ankesave, hetimi i ankesave, bashkëpunimi me agjencitë e tjera ligjzbatuese, hartimi i raporteve inspektuese, çështje të etikës së inspektorit, si edhe statusin e tyre. Në ditën e tretë të trajnimit, vetë inspektorët prezantuan raste praktike studimore mbi shkeljen e rregullave të etikës. Në vijim të këtij aktiviteti, ka filluar bashkëpunimi me të njëjtët partnerë ndërkombëtarë për të organizuar, sesione trajnimi për etikën me fokus forcimin e bashkëpunimit institucional me Komisionin e Etikës të Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe me kryetarët e gjykatave. Këto aktivitete vlerësohet të adresojnë edhe çështjet e ngritura nga GRECO në raportin vlerësues të raundit IV për Shqipërinë⁸, ku përsa i takon luftës kundër korrupsionit në radhët e gjyqtarëve, ka rekomanduar shtimin e trajnimeve mbi etikën, parandalimin e konfliktit të interesave dhe të korrupsionit, si dhe qasjen proaktive ndaj rasteve të shkeljes të etikës nga Komisioni i Etikës së Konferencës Gjyqësore Kombëtare.

Ankesat e verifikuara



Nga analiza e të dhënave konstatohet se shkelja dominante e konstatuar nga procesi i verifikimit të ankesave të qytetarëve është zvarritja e gjykimeve. Konkretisht nga 207 ankesa të verifikuara, 122 prej tyre (58.9 %) kanë patur për objekt zvarritjen e procesit gjyqësor. Për këtë shkak IKLD ka vepruar me gjurmimin e këtyre rasteve, duke përdorur të gjitha instrumentet e njohura nga ligji. Në këtë kontekst është menduar se kjo qasje i shërben adresimit të një prej çështjeve të

⁸ *Shih* Raporti i Vlerësimit të Shqipërisë, Raundi IV, “Parandalimi i korrupsionit tek anëtarët e Kuvendit, gjyqtarët dhe prokurorët”, i miratuar më 28 mars 2014 dhe i publikuar më 27 qershor 2014

ngritura nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit të vitit 2014 lidhur me efikasitetin e sistemit gjyqësor, ku evidentohen si çështje shqetësuese procedurat gjyqësore të gjata dhe joefektive dhe çështjet e prapambetura.

- Ankesa të arkivuara

Sipas nenit 27 të Rregullores së IKLD-së, një ankesë e paraqitur vlerësohet paraprakisht për elementët formalë dhe në përfundim të kësaj faze të shqyrtimit paraprak, nëse ankesa vlerësohet e papërshtatshme në formë apo në përmbajtje, atëherë procedohet me arkivimin e saj, duke njoftuar edhe ankuesin. Gjatë vitit 2014, IKLD ka proceduar me arkivimin e 676 ankesave të paraqitura, për shkaqet e listuara më poshtë:

- Ankesa është paraqitur tej afateve ligjore në 15 raste;
- Pretendimet e ngritura në ankesë zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor në 368 raste;
- Ankesa është e përsëritur dhe është trajtuar administrativisht më parë nga IKLD në 254 raste;
- Ankesa lidhet me subjekte të tjera, të ndryshme nga gjyqtarët (noterë, përmbarues, avokatë, prokurorë, drejtues të organeve të pushtetit vendor etj) në 39 raste. Në 13 prej këtyre rasteve, ankesa i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Përgjithshme, nga të cilat në 1 rast, ankuesit ngrinin pretendime për fakte korruptive të kryera nga gjyqtarët.

Nga analiza e këtyre të dhënave konstatohet se, ashtu si edhe në vitin 2013, edhe në vitin 2014 ka qenë shqetësues numri i ankesave, të cilat arkivohen. Ky numër i lartë, që zë 76.5 % të ankesave të paraqitura është thajse i pandryshuar me atë të vitit 2013, që zinte 76 % të volumit të ankesave të paraqitura. Ky numër i lartë është tregues i informimit të ulët ligjor të qytetarëve mbi sistemin ligjor, të drejtat e tyre dhe mbi kompetencat e IKLD-së. Për këtë qëllim ka filluar një proces bashkëpunimi me Prezencën e OSBE-së në Tiranë për të përcaktuar një formë standard për ankesat, vënia në dispozicion të qytetarëve e formave standard për t'i përdorur në paraqitjen e ankesave, rritja e informimit të qytetarëve (me broshura), duke siguruar që informacioni dhe formularët e ankesave të publikohen dhe aksesohen lehtësisht në faqen zyrtare të KLD-së. Po ashtu, po punohet edhe për përmirësimin e informacionit në faqen zyrtare të KLD-së. Aktualisht, ka përfunduar hartimi i broshurave informative, të cilat janë shpërndarë në çdo gjykatë dhe janë publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit⁹.

- Të dhëna të tjera

Duhet evidentuar se gjatë vitit 2014, IKLD ka finalizuar edhe një ngarkesë pune që i përket vitit 2013 dhe që lidhet me verifikimin në vijim të 39 ankesave në pritje të vendimmarrjes përfundimtare të gjykatave. Nga këto 39 raste, 29 janë finalizuar, ndërsa 10 janë ende në proces verifikimi në vijim. Rezultatet e 29 ankesave të përfunduara janë si më poshtë:

- Në 4 raste, gjyqtarëve iu është tërhequr vëmendja me shkrim për zvarritje;
- Në 10 raste, janë konstatuar shkelje të lehta, të cilat i janë regjistruar gjyqtarit për efekte

⁹ Shih <http://kld.al/homepage/si-te-ankoem-prane-kld>

- të vlerësimit profesional dhe etik;
- iii. Në 15 raste, është konkluduar se shkelja që i atribuohet gjyqtarit nuk ekziston apo nuk provohet.

Në faqen zyrtare të internetit të KLD-së, për të rritur aksesin e qytetarëve është instaluar portali i ankesave *online* <http://kld.al/ankesat-online>. Megjithatë, impakti i procedurës online të ankesave të qytetarëve kundër gjyqtarëve dhe procedurave gjyqësore mbetet ende për t'u vlerësuar. Për adresimin e kësaj çështjeje është i nevojshëm një vlerësim teknik i këtij sistemi, përmirësimi i tij me modulet e nevojshme dhe shndërrimin e tij në një mjet efektiv për gjenerimin e statistikave. Mendohet që procesi i bashkëpunimit me Prezencën e OSBE-së të ndihmojë në këtë drejtim.

- o Mbi ankesat e paraqitura nga institucionet e treta

Gjatë vitit 2014, IKLD ka pritur 14 ankesa¹⁰ nga Avokati i Popullit dhe Prokuroria e Përgjithshme. Lloji dhe niveli i bashkëpunimit me këto institucione përshkruhet në kapitullin “Bashkëpunimi me Institucionet e tjera”.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2014 ka referuar 9 raste ankesash që lidhen me zvarritjen e gjykimit, mosrespektim formal të ligjit dhe shkelje të etikës. Rezultatet e këtyre ankesave janë si më poshtë:

- 4 ankesa janë verifikuar, nga të cilat në 1 rast i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional, në 1 rast është vendosur verifikimi në vijim, ndërsa në 2 raste nuk janë konstatuar shkelje në veprimtarinë e gjyqtarit;
- 5 ankesa janë arkivuar, nga të cilat 2 raste për shkak se ishin verifikuar më parë nga Inspektorati dhe Avokatit të Popullit i është kthyer përgjigje për rezultatet e verifikimit, ndërsa 3 raste lidhen me pretendime të zgjidhshme nëpërmjet apelimit gjyqësor.

Në të gjitha këto raste, Avokati i Popullit është njoftuar me shkrim mbi ecurinë e shqyrtimit administrativ të ankesave.

Prokuroria e Përgjithshme ka referuar 5 raste ankesash, nga të cilat 3 ankesa janë paraqitur drejtpërdrejt nga vetë Prokurori i Përgjithshëm në cilësinë e ankuesit, ndërsa 2 ankesa janë dërguar për kompetencë nga strukturat e Prokurorisë së Përgjithshme. Rezultatet e këtyre ankesave janë si më poshtë:

- 1 ankesë e Prokurorit të Përgjithshëm është verifikuar dhe pasi janë konstatuar shkelje në ushtrimin e detyrës nga gjyqtari (mosarsyetim i vendimit gjyqësor), materialet i janë përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për të vlerësuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor;
- 2 ankesa të Prokurorit të Përgjithshëm, për mosrespektim formal të ligjit, janë verifikuar dhe është vendosur verifikimi i tyre në vijim, gjer në vendimmarrjen e gjykatave më të larta mbi çështjet gjyqësore në fjalë;
- 2 ankesa të përcjella për kompetencë janë arkivuar (1 ankesë për shkak përsëritje dhe 1 ankesë me arsyetimin se pretendimet zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor.

¹⁰ Këto ankesa janë pjesë e numrit të përgjithshëm të ankesave 883 dhe rezultatet e tyre janë pjesë e rezultateve të përgjithshme, të trajtuara tek rubrika “Verifikimi i ankesave, faqe 7-13

Në të gjitha këto raste, Prokuroria e Përgjithshme është njoftuar me shkrim mbi ecurinë e shqyrtimit administrativ të ankesave.

2. Raportimi periodik i kryetarëve

Duke marrë shkas nga problematika e evidentuar nga inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Elbasan mbi vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, si pasojë e të cilave u shkarkuan nga detyra dy gjyqtarë, Zëvendëskryetari i KLD-së me shkresën nr. 1464 prot., datë 25.09.2012 iu drejtua të gjithë kryetarëve të gjykatave me kërkesë për informim periodik mbi çështjet e mëposhtme:

- i. Respektimin e afatit të dorëzimit të vendimeve të arsyetuara në sekretarinë gjyqësore, duke evidentuar si të paarsyeshme vonesat mbi 30 ditë nga shpallja e vendimit;
- ii. Probleme të respektimit të disiplinës në punë;
- iii. Respektimin e normave të etikës gjyqësore me palët pjesëmarrëse, me kolegët dhe titullarin e gjykatës
- iv. Zbatimin e vendimit nr. 232/8, data 07.07.2008 të KLD-së “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”;
- v. Vonesat e seancave gjyqësore;
- vi. Çdo situatë tjetër problematike të konstatuar.

Me shkresën nr. 1400 prot, datë 22.04.2014, nga KLD-së, iu është kërkuar kryetarëve të gjykatave të përfshinin në informacionin periodik mujor, veç sa më sipër, edhe raportimin mbi instalimin dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit audio të implementuar në gjykatat respektive, mbi funksionimin e sistemit ICMIS, si dhe me rastet dhe arsyet e mbajtjes së procesverbaleve me dorëshkrim, për të gjitha rastet që do të evidentohen prej tyre.

Gjatë vitit 2014, prej kryetarëve të gjykatave është paraqitur informacioni periodik i kërkuar në lidhje me problematikat e konstatuara në gjykatat respektive. Në disa muaj ku nuk është raportuar nga të gjitha gjykatat ç’ka është pasqyruar në analizën e bërë në materialin mujor të paraqitur pranë Zëvendëskryetarit të KLD-së çdo muaj. Vlerësimi i këtyre informacioneve është kryer si proces me mbështetjen e Sektorit Juridik dhe të Dokumentacionit të Drejtorisë Juridike – konkretisht nga specialistja Brunilda Çarçiu.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura përgjatë gjithë vitit është konstatuar se problematika kryesore e referuar lidhej me vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Për muajt Maj dhe Korrik, numri i gjyqtarëve të apelit dhe numri i vendime të arsyetuara me vonesë prej tyre, është i lartë, për shkak se gjyqtarët e apelit kanë qënë gjyqtar të deleguar nga KLD për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit. Në tabelën e mëposhtme jepen statistikat mbi vonesat në arsyetimin e vendimeve sipas gjyqtarëve dhe 30 gjykatave, të ndara në të dyja nivelet e juridiksionit të zakonshëm dhe të krimeve të rënda.

Muaji	Nr. Gjyqtarëve		Nr. Gjykatave		Nr. Vendimeve	
	Apel	Shkalla 1	Apel	Shkalla 1	Apel	Shkalla 1
Janar	1	3	1	1	1	9
Shkurt	-	2	-	2	-	2
Mars	-	1	-	1	-	1

Prill	-	1	-	1	-	5
Maj	2	2	2	2	49	6
Qershor	2	2	2	2	5	20
Korrik	5	2	1	2	105	24
Shtator	-	1	-	1	-	1
Tetor	1	-	1	-	3	-
Nëntor	-	-	-	-	-	-
Dhjetor	1	-	1	-	3	-
Gjithsej¹¹	10	8	5	3	166	68

Krahasimi i të dhënave gjithsej midis viteve 2014 dhe 2013, jepet në tabelën e mëposhtme.

Muaji	Nr. Gjyqtarëve		Nr. Gjykatave		Nr. Vendimeve	
	Apel	Shkalla 1	Apel	Shkalla 1	Apel	Shkalla 1
Viti 2014	10	8	5	3	166	68
Viti 2013	16	44	6	10	154	312

Nga analiza e të dhënave konstatohet se tendenca për numrin e gjyqtarëve, gjykatave, si dhe numrin e vendimeve për vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 për gjykatat e nivelit të zakonshëm ka qenë në rënie. Nga ky krahasim konstatohet përkeqësim vetëm për numrin e vendimeve në gjykatat e apelit, e cila shpjegohet nga ngarkesa e këtyre gjyqtarëve në muajt maj dhe korrik 2014 për shkak të delegimit të tyre për llogari të Gjykatës së Apelit Administrativ.

Në mesin e muajit prill 2014, i njëjti mekanizëm raportimi u vendos edhe me kryetarët e gjykatave administrative. Nga muaji Prill – Dhjetor 2014, prej kryetarëve të gjykatave administrative është paraqitur informacioni periodik i kërkuar në lidhje me problematikat e konstatuara në gjykatat respektive. Përgjithësisht nga kryetarët e këtyre gjykatave raportohet në mënyrë të rregullt, me përjashtim të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë që nuk është raportuar që nga muaji Maj 2014. Edhe vlerësimi i këtyre informacioneve është kryer si proces me mbështetjen e Sektorit Juridik dhe të Dokumentacionit të Drejtorisë Juridike nëpërmjet specialistes Brunilda Çarçiu.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura përgjatë Prill-Dhjetor të vitit 2014 është konstatuar se në lidhje me vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore problematika më e madhe është në Gjykatën e Administrative të Apelit. Megjithatë, konstatohet se tendenca, si për numrin e gjyqtarëve, ashtu edhe për numrin e vendimeve gjyqësore të Apelit Administrativ ka një ulje të madhe që nga muaji Shtator. Përsa i përket gjykatave administrative të shkallës së parë ndonëse mjaft i vogël si numri i gjyqtarëve dhe i vendimeve ka një fillim problematike të kësaj natyre në muajt Nëntor dhe Dhjetor. Problematika e vonesave në Gjykatën e Apelit Administrativ lidhet me volumin e lartë të çështjeve në këtë gjykatë, për të cilën KLD me vendimin nr. 149, datë 05.12.2014 “Për kryerjen e një studimi vlerësues mbi ngarkesës e punës në Gjykatën Administrative të Apelit”, vendosi kryerjen e një studimi për volumin e çështjeve gjyqësore të regjistruara dhe të gjykuara, në këtë gjykatë. Studimi, i shqyrtuar dhe i miratuar në mbledhjen

¹¹ Në nxjerrjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve dhe të gjykatave, është mbajtur në konsideratë, që i njëjti gjyqtar apo e njëjta gjykatë ka patur vonesa në muaj të ndryshëm

plenare të datës 03.03.2015 të KLD-së¹², analizoi kushtet organizative dhe administrative të funksionimit të Gjykatës Administrative të Apelit, identifikoi problematikat përgjatë periudhës 1-vjeçare të funksionimit të gjykatave administrative, si dhe dha disa rekomandime për adresimin e këtyre problematikave. Ndër rekomandimet e tij, më kryesorët lidhen me rishikimin e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit në drejtim të rritjes së këtij numri dhe emërimin e shpejtë të ndihmësve ligjorë.

Të dhënat e raportuara mbi vonesat në arsyetimin e vendimeve jepen në tabelën e mëposhtme.

Muaji	Nr. Gjyqtarëve		Nr. Gjykatave		Nr. Vendimeve	
	Apel	Shkalla 1	Apel	Shkalla 1	Apel	Shkalla 1
Maj	6	-	1	-	402	-
Qershor	6	-	1	-	158	-
Korrik	6	-	1	-	303	-
Shtator	-	-	-	-	-	-
Tetor	3	-	1	-	24	-
Nëntor	3	2	1	1	10	5
Dhjetor	3	2	1	1	17	7
Gjithsej¹³	7	3	1	1	914	12

Raporti i Progresit i vitit 2013, lidhur me përgjegjshmërinë e gjyqësorit, ndër të tjera thekson “Nuk ka patur progres në përmirësimin e vendimeve gjyqësore, sidomos përse i përket arsyetimit. Për më tepër, vendimet gjyqësore përgjithësisht shpallen pa arsyetim, i cili në shumicën e rasteve bëhet pas një vonese domethënëse”. I njëjti qëndrim konfirmohet edhe në Raportin e Progresit 2014, ku shënohet “vendimet gjyqësore kur shpallen, nuk jepet arsyetimi i tyre gjithnjë dhe afatet nuk respektohen gjithnjë”¹⁴.

Për këtë arsye, arsyetimi në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore është mbajtur në vëmendje konstante dhe të gjitha rastet e vonuara mbi 30 ditë janë verifikuar. Kjo është arsyeja që nuk qëndron pretendimi i disa gjyqtarëve, i ngritur në mbledhje plenare të KLD-së, që gjyqtarët janë verifikuar në mënyrë selektive, pavarësisht se vonesa kanë patur edhe gjyqtarë të tjerë. Inspektorati ka verifikuar çdo rast, kur vonesa ka tejkaluar 30 ditë.

Lidhur me çështjet e tjera të kërkuara për raportim, nga Kryetarët është informuar se në gjykatat respektive nuk ka patur probleme të disiplinës në punë. Përgjithësisht është raportuar se nuk ka patur ndonjë problematikë në lidhje me respektimin e normave të etikës gjyqësore me palët pjesëmarrëse dhe me kolegët e titullarin e gjykatës, as në lidhje me zbatimin e vendimit të KLD-së “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit” dhe as për vonesa të mundshme në fillimin e seancave gjyqësore, vonesat e vogla kanë qënë për shkaqe objektive. Prej Kryetarëve herë pas here janë raportuar problematika të tjera mbi infrastrukturën e gjykatave, plotësimin e organikës, stafin administrativ, si dhe për funksionimin e sistemit audio e

¹² Shih <http://kld.al/korniza-ligjore/akte-n%C3%ABnligjore/studimi-mbi-ngarkesen-ne-gjykatën-administrative-te-apelit>

¹³ Në nxjerrjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve dhe të gjykatave, është mbajtur në konsideratë, që i njëjti gjyqtar apo e njëjta gjykatë ka patur vonesa në muaj të ndryshëm

¹⁴ Shih, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf

ICMIS. Këto shqetësime, të cilat janë vlerësuar se nuk kanë qënë në kompetencë të KLD, në parimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, i janë përcjellë për trajtim institucionit përkatës si Ministrisë së Drejtësisë, ZABGJ dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Përgjithësisht, institucionet e treta janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të KLD-së, duke raportuar mbi situatën dhe planet për zgjidhjen e tyre.

Kryetarët e Gjykatave Administrative kanë informuar se në gjykatat respektive nuk ka patur probleme të disiplinës në punë, me përjashtim të pjesmarrjes së ulët të trupës gjyqësore në mbledhjen e mëngjesit, raportuar nga Kryetari i gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Për këtë iu drejtua shkresë gjithë trupës gjyqësore, ku u evidentua fakti se pjesmarrja është detyrim që buron nga ligji. Nuk është raportuar ndonjë problematikë në lidhje me respektimin e normave të etikës gjyqësore me palët pjesëmarrëse dhe me kolegët e titullarin e gjykatës, as në lidhje me zbatimin e vendimit të KLD-së “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit” dhe as për vonesa të mundshme në fillimin e seancave gjyqësore. Nga të gjithë Kryetarët e Gjykatave Administrative është ngritur si problem shqetësues, në informacionet periodike, ngarkesa e madhe e çështjeve që ka secili gjyqtar. Është ngritur po ashtu, problemi i plotësisht të organikës me numrin përkatës të gjyqtarëve, domosdoshmëria e emërimit të ndihmësve ligjorë. Problematikë kanë paraqitur në lidhje me infrastrukturën (gjykatat me një sallë gjykimi), pa hapësira të mjaftueshme për zyra; mungesën e sistemit audio dhe ICMIS dhe mungesën e informacionit në internet për këto gjykata; mungesën e ndihmësve ligjor dhe administratës së kualifikuar, të cilat edhe këto sipas rastit i janë përcjellë për zgjidhje organit kompetent.

Në 2 raste të veçanta janë raportuar nga kryetarët e gjykatave çështje të shkeljes së etikës së gjyqtarit (1 gjyqtar i shkallës së parë dhe 1 gjyqtar i shkallës së dytë). Të dyja këto raste janë verifikuar.

Procesi i verifikimit për të gjitha problematikat e raportuara është mbështetur në nenin 21 të Rregullores së IKLD-së, pika 2 e të cilit parashikon se IKLD verifikon në çdo rast shqetësimet apo informacionet e përcjellura nga kryetarët. Konkretisht është verifikuar veprimtaria e 20 gjyqtarëve në vitin 2014 (6 mujori i parë)¹⁵ dhe nga verifikimi, janë nxjerrë të dhënat e mëposhtme:

- i. Për 1 gjyqtar të shkallës së parë, materialet e verifikimit i janë përcjellë Ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor për vonesë në arsyetimin e vendimeve dhe për mospërdorim të sistemit audio të seancave gjyqësore. Ky rast u paraqit nga Ministri i Drejtësisë dhe KLD me vendimin nr. 20, datë 03.03.2015 dha masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarit. Në shtesë të këtyre informacioneve, janë verifikuar edhe 2 rastet e veçanta për shkelje të etikës dhe për mosrespektim formal të ligjit. Në rastin që lidhej me shkelje të rregullave të etikës, është bashkëpunuar me Komisionin e Etikës të Konferencës Gjyqësore Kombëtare. Të dyja këto raste në përfundim të verifikimit, materialet i janë përcjellë Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të 2 gjyqtarëve;
- ii. Për 1 gjyqtar, të konstatuar me shkelje në vonesa të arsyetimit të vendimeve, është

¹⁵ Raportimet e muajve të tjerë janë në proces

tërhequr vëmendja me shkrim bazuar në nenin 34 pika 2 të Rregullores së IKLD-së me arsyetimin se rasti i verifikuar ka qenë i pamjaftueshëm për të iniciuar përshtatshëm një procedim disiplinor. Në këto raste është konstatuar që numri i vendimeve të arsyetuara me vonesë prej tyre ka qenë i ulët dhe se vonesa e gjyqtarit ka qenë rezultat edhe i ngarkesës së tij në detyrë;

- iii. Për 12 gjyqtarë, rezultatet e verifikimit janë regjistruar për efekte të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarit në drejtim të aftësisë për të arsyetuar në kohë vendimet gjyqësore;
- iv. Në 2 raste është nxjerrë përfundimi se informacioni mbi vonesat e vendimeve i dërguar ka qenë i pasaktë dhe materialet janë arkivuar.
- v. Në 2 raste është vendosur arkivimi me arsyetimin se nuk ka patur shkelje në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit në drejtim të arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore.

Gjatë vitit 2014, Inspektorati ka vijuar edhe verifikimin e raportimeve periodike të paraqitura nga gjykatat për muajt nëntor dhe dhjetor 2013, të cilat sipas raportimit të mëparshëm ishin në procesin e përpunimit të rezultateve të verifikimit. Konkretisht është verifikuar veprimtaria e 13 gjyqtarëve dhe nga verifikimi, janë nxjerrë të dhënat e mëposhtme:

- i. Për 1 gjyqtar, që është konstatuar me shkelje në drejtim të vonesës në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, i është tërhequr vëmendja me shkrim bazuar në nenin 34 pika 2 të Rregullores së IKLD-së me arsyetimin se rasti i verifikuar ka qenë i pamjaftueshëm për të iniciuar përshtatshëm një procedim disiplinor. Në këtë rast është konstatuar që numri i vendimeve të arsyetuara me vonesë prej tyre ka qenë i ulët dhe se vonesa e gjyqtarit ka qenë rezultat edhe i ngarkesës së tij në detyrë;
- ii. Për 8 gjyqtarë, rezultatet e verifikimit janë regjistruar për efekte të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarit;
- iii. Për 3 gjyqtarë është vendosur arkivimi pasi nuk ka shkelje;
- iv. Për 1 gjyqtar është sugjeruar që KLD të vendosë inspektimin me karakter disiplinor me afat 1-2 vjeçar për vonesat në dorëzimin e arsyetuar të vendimeve.

Procesi i verifikimit të raportimeve të kryetarëve është kryer nga inspektorët Fatbardh Çoniku (3 raste), Hajrie Muçmata (2 raste), Izet Salaj (16 raste), Kujtim Vraniçi (3 raste), Marsela Pepi (20 raste), Qemal Zaimi (10 raste), Sofie Zhilla (1 rast), Vojsava Osmanaj (1 rast) dhe Zhaneta Pira (2 raste).

Mekanizmi i raportimit të kryetarëve vlerësohet të jetë një mjet i mirë për monitorimin e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe të gjykatave, megjithatë ka ende vend për përmirësim në këtë drejtim. Në të ardhmen duhet gjetur një mënyrë për standardizimin e këtij informacioni për përpunimin më të lehtë dhe më të saktë të tij. Po ashtu, i duhet kushtuar vëmendje edhe saktësisë së informacionit të paraqitur nga kryetarët e gjykatave.

3. Inspektimi tematik

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenet 143 dhe 147 të Kushtetutës, si dhe të neneve 1 dhe 16 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar kontrollon ligjshmërinë e veprimtarisë së gjykatave dhe inspekton

gjyqtarët, me qëllim respektimin e Kushtetutës, ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe kujdeset që kjo veprimtari të kryhet në pajtim me detyrën e gjyqtarit.

Në këtë kuadër, në zbatim të vendimit nr. 51, datë 17.04.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe urdhrit nr. 1340/9 prot datë 06.05.2014 të Zëvendëskryetarit të KLD-së, Inspektorati i KLD-së, inspektoi ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Dhimitër Pojanaku për vitin kalendarik 01.01.2012- 31.12.2012. Shkak për inspektimin e veprimtarisë gjyqësore apo jashtë gjyqësore të këtij gjyqtari ishte “arrestimi i tij në flagrancë” nga policia gjyqësore për “korrupsion”.

Inspektimi i përgjithshëm i gjyqtarit Dhimitër Pojanaku për periudhën 1 –vjeçare pati në objektin e tij:

- evidentimin në nivel statistikor mbi efektivitetin në detyrë në drejtim të kohës, cilësisë dhe sasisë, duke iu referuar parametrave të Sistemit të Vlerësimit të gjyqtarëve. Në këtë kontekst, u analizuan edhe rastet e heqjes dorë apo të përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimi i çështjeve;
- verifikimin e çdo fakti tjetër, që sipas nenit 32 të ligjit nr. 9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përbëjnë bazë për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit;

Inspektimi u zhvillua bazuar në tre faza, duke respektuar procedurën e përcaktuar në ligj, në Rregulloren e Inspektoratit dhe standardet e metodologjinë e Manualit të Inspektimeve. Në fazën e parë të veprimtarisë paraprake u përcaktua, kalendari i punës dhe u grumbullua materiali dokumentar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ndërsa, në fazën e dytë u realizua inspektimi në gjykatë ku u verifikuan rezultatet e fazës paraprake. Në fazën e tretë dhe të fundit, u procedua me përpunimin e materialit të grumbulluar dhe me hartimin e këtij Raporti. Inspektimi u realizua nga një grup kontrolli i përbërë prej 2 inspektorëve Marsela Pepi dhe Qemal Zaimi, nën drejtimin e kryeinspektores Marsida Xhaferllari.

Në përfundim të këtij inspektimi u konkludua se gjyqtari Dhimitër Pojanaku ka shkelur dispozitat urdhëruese procedurale civile në mënyrë të përsëritur, si dhe ka shkelur detyrimin për arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Nga analiza e këtyre shkeljeve janë dhënë 3 rekomandime, ku rekomandimi kryesor lidhet me procedimin disiplinor të gjyqtarit Dhimitër Pojanaku.

4. Përpunimi administrativ i vendimeve të cenuara

Sipas nenit 16 pika 3 të ligjit nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar, IKLD kryen detyra të tjera, të caktuara nga KLD. Këshilli me vendimin nr. 262/4, datë 24.04.2010, ka disponuar:

"Ngarkohet Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për ndjekjen në vazhdimësi të vendimeve të cenuara të gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve, si edhe për pasqyrimin në mënyrë periodike të shkaqeve të cenimit të vendimeve nga gjykatat më të larta, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vendimeve të prishura si pasojë e shkeljes së dispozitave urdhëruese procedurale apo për moszbatim të vendimit unifikues dhe vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur sipas kodeve të procedurave,

janë të detyrueshme."

Për realizimin e kësaj detyre, IKLD gjatë vitit 2014 ka trajtuar 751 vendime gjyqësore të cenuara të dhëna në vitet 2007-2014, duke analizuar shkaqet e cenimit dhe duke proceduar me verifikimin e 68 vendimeve, për të cilat janë nxjerrë 20 urdhra verifikimi. Për vlerësimin paraprak të këtyre rasteve është ngarkuar posaçërisht inspektorja Sofie Zhilla. Duke iu referuar të dhënave të vitit 2013, konstatohet se gjatë vitit 2013, IKLD ka trajtuar 421 vendime gjyqësore të cenuara, duke analizuar shkaqet e cenimit dhe duke proceduar me verifikimin e 35 rasteve. Nga krahasimi i këtyre të dhënave konstatohet se ka një rritje të volumit të punës të kryer nga IKLD, si në fazën e shqyrtimit paraprak të tyre, ashtu edhe në verifikimin e rasteve konkrete.

Të dhënat statistikore të vendimeve të cenuara, të përpunuara nga IKLD, jepen në tabelën e mëposhtme.

Nr	Gjykata	Nr.Vend ¹⁶	V.Unifikues	Arsyetim	Disp proc.	Të tjera	Verifikim
1	Apeli Tiranë	34	4	-	-	1	5
2	Gj.Rr.Dibër	17	-	-	-	-	-
3	Gj.Rr.Krujë	-	-	-	-	-	-
4	Gj.Rr.Kurbin	-	-	-	-	-	-
5	Gj.Rr.Mat	4	-	-	-	-	-
6	Gj.Rr.Tiranë	82	12	2	-	-	14
7	Apeli Durrës	12	1	-	-	-	1
8	Gj.Rr.Elbasan	13	1	-	-	-	1
9	Gj.Rr.Durrës	-	-	-	-	-	-
10	Gj.Rr.Kavajë	-	-	-	-	-	-
11	Apeli Shkodër	-	-	-	-	-	-
12	Gj.Rr.Gj.Lezhë	2	-	-	-	-	-
13	Gj.Rr.Gj.Kukës	-	-	-	-	-	-
14	Gj.Rr.Pukë	-	-	-	-	-	-
15	Gj.Rr.Gj. Shkodër	6	-	-	-	-	-
16	Gj.Rr.Gj.Tropojë	-	-	-	-	-	-
17	Apeli Vlorë	-	3	-	-	-	3
18	Gj.Rr.Gj.Berat	64	1	1	-	-	2
19	Gj.Rr.Gj.Fier	37	1	1	-	-	2
20	Gj.Rr.Gj.Lushnjë	45	2	-	2	-	4
21	Gj.Rr.Gj.Vlorë	289	11	10	3	4	28
22	Apeli Korçë	-	-	-	-	-	-
23	Gj.Rr.Gj.Pogradec	1	-	-	-	-	-
24	Gj.Rr.Gj.Korçë	10	-	-	-	-	-
25	Apeli Gjirokastër	-	1	-	-	-	1
26	Gj.Rr.Përmet	16	-	-	-	-	-
27	Gj.Rr.Gj.Sarandë	29	2	1	-	-	3
28	Gj.Rr.Gjirokastër	23	-	1	-	-	1
29	Ap.Krime Rënda	17	1	-	-	-	1
30	Shk.I Kr të Rënda	50	2	-	-	-	2
	Gjithsej	751	42	16	5	5	68

Rezultatet e 20 urdhrave të verifikimit janë si më poshtë:

¹⁶ Në këtë kolonë janë shënuar numrat e vendimeve të paraqitura nga gjykatat dhe rrjedhimisht, një gjykatë mund të ketë paraqitur edhe vendime që i përkasin të njëjtës çështje, të dhëna nga gjykata më e lartë apo më e ulët.

- Në 4 raste nuk janë konstatuar shkelje në veprimtarinë e gjyqtarëve;
- Në 15 raste, janë evidentuar shkelje të lehta, të cilat iu janë regjistruar gjyqtarëve për efekte të vlerësimit profesional dhe etik të tyre;
- Në 3 raste, vijon procesi i verifikimit deri në vendimmarrjen përfundimtare nga gjykatat më të larta;
- Në 2 raste, inspektorët janë në procesin e hartimit të raportit përfundimtar;
- Në 4 raste, është sugjeruar kalimi i materialit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me qëllim saktësimin e detyrave të Inspektoratit në këtë proces, bazuar në vendimin nr. 262/4, datë 24.04.2010. Konkretisht, sugjerohet të saktësohet nëse këto vendime të cenuara të dërguara nga kryetarët e gjyqtarëve janë të afta për të filluar një procedim disiplinor të gjyqtarit apo jo, për shkak të mungesës formale të ankesës për to. Përvoja ka treguar se kryetarët e gjykatave këto vendime thjesht i përcjellin në Inspektorat pa paraqitur mendimin e tyre mbi to.

5. Të dhëna të përgjithshme

Në vitin 2014 i janë dërguar Ministrisë të Drejtësisë 21 raste të verifikimit të ankesave¹⁷ nga Inspektorati i KLD-së ndaj 15 gjyqtarëve (1 gjyqtar i Gjykatës së Apelit dhe 14 gjyqtarë të Gjykatave të Shkallës së Parë) për të iniciuar procedimin disiplinor ndaj tyre. Në 6 raste, për të njëjtin gjyqtar janë dërguar materialet e verifikimit të dy ankesave ndaj tij. Shkeljet në këto 20 raste lidhen me zvarritjen e gjykimit dhe vonesat në arsyetimin e vendimeve (10 raste), shkelje të rregullave të etikës (3 raste), moszbatim i vendimit unifikues (1 rast), mungesë e arsyetimit të vendimit (3 raste), mosrespektim formal i ligjit nëpërmjet shkeljes së dispozitave procedurale urdhëruese (3 raste).

Në raport me vitin 2013, ku janë dërguar 23 raste ankesash, që lidheshin me veprimtarinë gjyqësore të 15 gjyqtarëve, konstatohet se numri i ankesave është më i ulët, por numri i gjyqtarëve është i njëjtë. Në analizën e këtij treguesi, duhet evidentuar se gjatë vitit 2013, Inspektorati ka finalizuar edhe një volum pune të prapambetur që i përkiste ankesave të paraqitura në vitet 2010-2012. Në këtë situatë, nxirret përfundimi se ritmi i punës në Inspektorat për procedimin disiplinor të gjyqtarëve është në rritje, që i ka shërbyer objektivit për forcimin në mënyrë thelbësore të sistemit disiplinor të gjyqtarëve.

¹⁷ Me termin ankesë këtu nënkuptohen jo vetëm ankesat e qytetarëve, por edhe raportimet e kryetarëve të Gjykatave, si dhe rastet e inspektimit të gjyqtarit të vendosura nga KLD

III. VLERËSIMI PROFESIONAL TË GJYQTARËVE

Një përgjegjësi tjetër shumë e rëndësishme e Inspektoratit është grumbullimi i të dhënave dhe hartimi i projektakteve të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve (nenet 16 pika 1 shkronja 'dh' të ligjit nr. 8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së", i ndryshuar dhe neni 13 i ligjit nr. 9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh", i ndryshuar). Finalizimi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe krijimi i një tradite institucionale të këtij procesi ka qenë një prej dy prioritetëve kryesorë të IKLD-së, i përcaktuar nga KLD, për shkak të lidhjes së tij të drejtpërdrejtë me sistemin e karrierës së gjyqtarëve bazuar në merita. Në Raportin Analitik të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2010 evidentohet si problematikë kryesore mungesa e një sistemi vlerësimi për gjyqtarët, që shkaktonte uljen e nivelit të cilësisë dhe dobësimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor në Shqipëri. Kjo shoqërohej edhe me mungesën e një sistemi transferimesh dhe promovimesh bazuar në meritat profesionale. Në Raportet e Progresit të viteve 2011 dhe 2012 vihej sërish theksi tek sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve, duke e lidhur atë me sistemin e promovimit të gjyqtarëve bazuar në merita. Progresi Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2014¹⁸ evidenton se përsa i përket vlerësimit të gjyqtarëve, procesi i vlerësimit të veprimtarisë së gjyqtarëve gjatë viteve 2005-2006 u përfundua në Janar dhe ka filluar vlerësimi për vitet 2007-2009. Ka nevojë që kriteret e vlerësimit të konsiderojnë më shumë ngarkesën e punës të gjyqtarëve në të gjitha nivelet.

Gjatë vitit kalendarik 2014, konkretisht më 27.01.2014¹⁹ u finalizua **për herë të parë në Republikën e Shqipërisë raundi i parë i vlerësimit profesional të gjyqtarëve për vitet 2005-2006, të cilit iu nënshtruan 279 gjyqtarë**. Përfundimi i këtij procesi u realizua në sajë të punës voluminoze të stafit të përfshirë në këtë proces. Rezultatet e këtij procesi lehtësuan edhe në hartimin e listës përfundimtare të renditjes së gjyqtarëve, si dhe ndikuan në procesin e promovimeve dhe të transferimeve të gjyqtarëve.

IKLD filloi menjëherë procesin e vlerësimit të gjyqtarëve për vitet 2007-2009. Për këtë qëllim u përgatit Programi "Mbi përcaktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve që do t'i nënshtrohen vlerësimit etiko-profesional për periudhën 2007-2009 përgjatë vitit 2014", i cili u miratua nga KLD me vendimin nr. 413, datë 16.12.2013 bazuar në nenin 2 pika 6 të Sistemit të Vlerësimit²⁰. Në këtë program u parashikua që numri i gjyqtarëve për t'u vlerësuar për vitet 2007-2009 ishte 303 gjyqtarë, të cilët kanë qenë gjyqtarë në vitet 2007-2009 dhe vazhdojnë të ushtrojnë detyrën edhe aktualisht. Ky numër gjyqtarësh u përcaktua duke mbajtur në konsideratë nenin 34 pika 2 të Sistemit të Vlerësimit, sipas të cilit, gjyqtarët që ruajnë statusin, megjithëse përkohësisht shërbejnë në institucione të tjera, do të vlerësohen pasi të rikthehen në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit.

Procesi i renditjes së gjyqtarëve brenda një gjykate u parashikua të ndiqte këto kriteret: (i) gjyqtarët, të cilët për shkak të emërimit pas vitit 2006, vlerësohen për herë të parë; (ii) gjyqtarët, të cilët kanë kandiduar për promovim; (iii) gjyqtarët, të cilët në vlerësimin 2005-2006 janë vlerësuar "Pranueshëm". Kjo renditje ishte e domosdoshme sidomos në gjykatat, të cilat kanë një numër gjyqtarësh më të lartë se 4, çka nënkupton se kapacitetet administrative brenda një gjykate

¹⁸ Shih Raporti i Progresit për Shqipërinë, Komisioni Evropian, {COM (2014) 700 final}, 08.10.2014, faqe 40

¹⁹ Me vendimin nr. 9/43, datë 17.01.2014 të KLD-së u miratua vlerësimi i gjyqtarit të fundit për vitet 2005-2006

²⁰ Vendimi i KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve"

ishin në pamundësi për të proceduar njëkohësisht me grumbullimin e akteve për të gjithë gjyqtarët. Nga ana tjetër, renditja u parashikua në funksion edhe të racionalizimit të burimeve njerëzore në Inspektoratin e KLD-së. Në renditje kronologjike sistemi i vlerësimit u përcaktua në këtë mënyrë:

1. **Juridiksioni i Apelit Durrës**, i cili përmbledh Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Kavajë, Durrës dhe Elbasan, gjithsej 41 gjyqtarë.
2. **Juridiksioni i Apelit Vlorë**, i cili përmbledh, Gjykatën e Apelit Vlorë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Lushnjë, Berat, Fier dhe Vlorë gjithsej 58 gjyqtarë.
3. **Juridiksioni i Apelit Gjirokastrë**, i cili përmbledh Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet, gjithsej 28 gjyqtarë.
4. **Juridiksioni i Apelit Korçë**, i cili përmbledh Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Korçë dhe Pogradec, gjithsej 30 gjyqtarë.
5. **Juridiksioni i Apelit Shkodër**, i cili përmbledh Gjykatën e Apelit Shkodër dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Lezhë, Shkodër, Kukës dhe Tropojë gjithsej 43 gjyqtarë.
6. **Juridiksioni i Apelit Tiranë**, i cili përmbledh Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Kurbin, Krujë, Mat, Dibër gjithsej 80 gjyqtarë.
7. **Juridiksioni i Apelit për Krime të Rënda**, i cili përmbledh Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, gjithsej 23 gjyqtarë.

Programi u hartua dhe u miratua në momentet e fundit të përfundimit të raundit të parë të vlerësimit me synimin e përfitimit të kohës. Komunikimi zyrtar me gjykatat filloi më 18.12.2013, konkretisht me gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës. Procesi vijoi me metodologji të qartë sipas programit, duke kërkuar dokumentacionin nga gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë më 28.01.2014, nga gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë më 20.02.2014, nga gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë më 20.03.2014, nga gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër më 12.06.2014 dhe nga gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë më 22.10.2014. Aktualisht, IKLD mbetet në pritje të depozitimit të materialeve nga këto gjykata të fundit për të proceduar me njoftimin e gjykatave nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila përmbyll të gjithë raundin e dytë.

Nën të njëjtin parashikim ligjor, IKLD hartoi edhe Programin “Mbi përcaktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve që do t’i nënshtrohen vlerësimit etiko-profesional për periudhën 2007-2009 përgjatë vitit 2014”, i cili u miratua nga KLD me vendimin nr. 6, datë 26.01.2015 bazuar në nenin 2 pika 6 të Sistemit të Vlerësimit. Edhe ky program ndoqi të njëjtën metodologji, duke vendosur si synim finalizimin e procesit brenda vitit 2015.

IKLD, për qëllime të efijencës, i kushtoi rëndësi punës përgatitore dhe rritjes së ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve pjesëmarrës në këtë proces. Në funksion të këtij qëllimi u zhvilluan takime periodike me kryetarët e gjykatave, sipas juridiksioneve duke dhënë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të vlerësimit. Në dispozicion të pyetjeve eventuale të kryetarëve të gjykatave u caktua inspektorja Hajrie Muçmata si person

kontakti, e cila ka hartuar edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të komunikimit me kryetarët e gjykatave. Po ashtu, u procedua me publikimin në faqen zyrtare të KLD-së të bazës ligjore të nevojshme dhe të formularëve tip, për të lehtësuar grumbullimin dhe plotësimin e saktë të informacionit. Ky informacion u publikua në faqen kryesore www.kld.al me emërtimin “Sistemi i Vlerësimit”.

Duhet evidentuar se, pavarësisht masave paraprake të marra, në disa raste ka patur vonesa nga kryetarët, që shpjegohet me disa faktorë: (i) volumi i punës dhe numri i gjyqtarëve; (ii) mbledhja e të dhënave manualisht sepse ende nuk ka të dhëna të besueshme statistikore që të gjenerohen automatikisht nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve në gjykata; (iii) ndryshimi i kryetarëve dhe i kancelarëve; (iv) rastet kur një gjyqtar ka ushtruar brenda periudhës së vlerësimit detyrën në 2 apo më shumë gjykata; dhe (v) rastet kur gjyqtari ka ushtruar detyrën në një gjykatë të suprimuar dhe mbledhja e dokumentacionit nga arkivat e vjetra.

Sistemi i Vlerësimit respekton parimin e njoftimit dhe pjesëmarrjes aktive të gjyqtarit në proces, duke i dhënë atij tiparin e kontradiktoritetit. Përveç të drejtës për t’u njoftuar dhe njohur me të gjitha aktet që grumbullohen, sipas nenit 20 të Sistemit të Vlerësimit, gjyqtari nën vlerësim, ka të drejtën e paraqitjes së aktit të vetëvlerësimit, të cilit mund t’i bashkëlidhë edhe prova eventuale që mbështesin qëndrimin e gjyqtarit. Në shtesë të kësaj të drejte, sipas nenit 26, gjyqtari nën vlerësim ka edhe të drejtën të kërkojë të intervistohet në Inspektorat. Pavarësisht këtyre të drejtave, deri më sot, është konstatuar një qëndrim indiferent i gjyqtarëve nën vlerësim, të cilët nuk i kanë ushtruar të drejtat e hartimit të vetëvlerësimit dhe të kërkesave për intervistë. Të dhënat tregojnë se nga 123 gjyqtarë, për të cilët është përfunduar projektakti përfundimtar i vlerësimit, vetëm 46 gjyqtarë kanë ushtruar të drejtën e pjesëmarrjes aktive gjatë procesit të vlerësimit (1 gjyqtar ka paraqitur vetëvlerësim dhe ka kërkuar intervistë; 35 gjyqtarë kanë paraqitur vetëvlerësim, por nuk kanë kërkuar intervistë; 4 gjyqtarë kanë kërkuar intervistë, por nuk kanë paraqitur vetëvlerësim). Në këtë situatë, IKLD vlerëson se këto mjete të gjyqtarit duhet të kthehen në detyrim për ta dhe jo në një mundësi alternative sepse pjesëmarrja aktive e gjyqtarit jo vetëm lehtëson procesin e vlerësimit, por ndërgjegjëson edhe vetë gjyqtarin për treguesit konkretë të veprimtarisë së tij gjyqësore.

Në kohën e përfundimit të hartimit të këtij Raporti Vjetor, të dhënat statistikore mbi ecurinë e vlerësimit profesional dhe etik për vitet 2007-2009, janë si më poshtë:

Procesi i vlerësimit të gjyqtarëve 2007-2009	
Akte të miratuara nga KLD	93
Akte të njoftuara gjyqtarëve në pritje për t’u shqyrtuar nga KLD	30
Të përjashtuar nga Vlerësimi për arsye të ndryshme	10
Akte në proces përfundimi nga kryeinspektorja	26
Në proces hartimi të relacionit përfundimtar nga inspektori	12
Në proces shortimi dhe vëzhgimi të dosjeve në gjykata nga inspektorët	25
Nr. i gjyqtarëve, për të cilët është paraqitur dokumentacioni nga gjykatat dhe është caktuar inspektori përgjegjës	73
Gjithsej	269

Këto të dhëna tregojnë se është finalizuar procesi i vlerësimit nga IKLD për 133 gjyqtarë, nga të cilët 116 gjyqtarë kanë ushtruar detyrën në gjykatat e shkallës së parë dhe 17 prej tyre në gjykatat e apelit. Nga këta 133 gjyqtarë, 59 prej tyre ishin femra, ndërsa 74 meshkuj. 22 prej 133 gjyqtarëve, e kanë vlerësimin e tyre të parë profesional dhe etik. Ky fakt shpjegohet me rastet e gjyqtarëve që kanë filluar detyrën pas vitit 2006 apo me rastet e gjyqtarëve, të cilët në vitet 2005-2006 kanë qenë të rekrutuar në detyra të tjera profesionale dhe etike.

Duke iu referuar kryesinspektorit dhe inspektorëve përgjegjës sipas rendit alfabetik, të dhënat janë si më poshtë:

Nr.	Kryeinspektori/Inspektori	Përfunduar	Në proces
1.	Marsida Xhaferllari	123	26
2.	Arjan Qafa	20	6
3.	Dashuri Gjunksi	17	5
4.	Fatbardh Çoniku	28	29
5.	Hajrie Muçmata	25	20
6.	Piro Samara	6	2
7.	Vojsava Osmanaj	28	24
8.	Zhaneta Pira	18	16
9.	Kujtim Vranici	0	8
10.	Të tjerë ²¹	7	-

Gjatë raundit të parë të vlerësimit 2005-2006, vetëm 3 gjyqtarë u vlerësuan “Pranueshëm”. Për të tre këto raste, IKLD procedoi me vlerësimin e radhës brenda 1 viti sipas nenit 13 pika 4²² të ligjit nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh”, i ndryshuar. Në raundin e dytë të vlerësimit, 2 prej këtyre gjyqtarëve u vlerësuan “Mirë”, ndërsa rasti i tretë është ende në proces. Rasti i tretë i përket gjyqtarit A.Ç, ndaj të cilit KLD mori masën disiplinore “shkarkim nga detyra” më 15.04.2014, por ky vendim është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 4, datë 13.10.2014. Në këtë situatë, IKLD e ka përfshirë sërish gjyqtarin Albano Çepele në skemën e vlerësimit dhe është e pritshme që vlerësimi i tij të përfundojë shumë shpejt.

Në 10 raste, megjithëse kishte filluar grumbullimi i akteve, gjyqtarët janë përjashtuar nga vlerësimi për këto arsye: (i) dhënie mase disiplinore ndaj gjyqtarit apo pezullim nga detyra në 2 raste; (ii) vdekja e gjyqtarit në 2 raste; (iii) ushtrimi i detyrës për më pak se 6 muaj në 1 rast; (iv) dalja në pension e gjyqtarit në 5 raste.

Të dhënat e vlerësimit të 123 gjyqtarëve nga IKLD janë si më poshtë:

Nr	Vlerësimi	Apel	Shkalla I	Gjithsej
1	Shumë Mirë (3)	1	24	25
2	Shumë Mirë (2)	7	54	61
3	Mirë (2+)	3	6	9
4	Mirë (3)	1	15	16

²¹ Këto vlerësime janë realizuar nga inspektorë, që kanë përfunduar detyrën në IKLD

²² Kjo dispozitë parashikon shprehimisht “Në rastin kur gjyqtari është vlerësuar “Pranueshëm”, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, brenda një viti, bën rivlerësimin e tij”

5	Mirë (2-)	0	6	6
6	Pranueshëm	1	5	6
Gjithsej		13	110	123

Të dhënat e vlerësimit të 93 gjyqtarëve nga KLD janë si më poshtë:

Nr	Vlerësimi	Apel	Shkalla I	Gjithsej
1	Shumë Mirë (3)	1	20	21
2	Shumë Mirë (2)	6	48	54
3	Mirë (2+)	3	4	7
4	Mirë (3)	0	7	7
5	Mirë (2-)	0	2	2
6	Pranueshëm	0	2	2
Gjithsej		10	83	93

Ndër 133 raste, 19 gjyqtarë kanë kundërshtuar projekatin përfundimtar të vlerësimit në KLD, nga të cilat KLD është shprehur në 10 raste. Në 5 raste, projekti është ndryshuar. Në 2 prej tyre, gjyqtari është vlerësuar Shumë Mirë nga KLD në ndryshim nga propozimi i IKLD për Shumë Mirë (2), 1 rast nga Mirë (2+) në Shumë mirë (2), ndërsa në 2 rastet e tjera rezultati përfundimtar nuk është ndryshuar, por KLD ka ndryshuar rezultatin e një prej grupkriterëve. Shkaqet kryesore të cenimit të akteve të Inspektoratit janë si më poshtë:

- Analiza e vendimeve të cenuara, me tendencën e përmirësimit të cilësisë së gjyqarrit;
- Shkaqet justifikuese të paraqitura nga gjyqtarët për zvarritjen e gjykimeve dhe tejkalimin e afateve në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në disa raste, gjyqtarët paraqitnin të dhëna individuale mbi vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore apo të gjykimeve, duke ia atribuar vonesat stafit administrativ në gjykata. Në disa raste të tjera, gjyqtarët paraqitnin të dhëna mbi kushtet e veçanta familjare dhe shëndetësore të tyre.

Ndër 93 raste të përfunduara nga KLD, vetëm 1 gjyqtar është ankuar në gjykatë për rezultatin e vlerësimit të miratuar nga KLD-ja. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e padisë së tij dhe çështja aktualisht ndodhet për gjykim në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Në shtesë të procesit të vlerësimit rutinë të raundit të dytë 2007-2009, IKLD është angazhuar edhe me procesin e vlerësimit të përsheptuar të gjyqtarëve, të cilët kandidonin për promovim. Konkretisht, u procedua me vlerësimin e përsheptuar të 4 gjyqtarëve për vitin kalendarik 2013, të cilët kandiduan për promovim në pozicionin e kryetarit të Gjykatës dhe që ishin emëruar në detyrë pas vitit 2009²³. Këto akte të vlerësimit të përsheptuar janë shqyrtuar dhe miratuar nga KLD në mbledhjen e datës 12 shtator 2014. Gjithashtu, në fund të vitit 2014, IKLD, bazuar në vendimin nr. 142, datë 05.12.2014, filloi procesin e grumbullimit të 8 gjyqtarëve, të rekrutuar në struktura të tjera profesionale dhe që kishin paraqitur kërkesa për promovim.

Sistemi i Vlerësimit është një mjet efikas edhe për njohjen e situatës së gjykatave. Megjithatë,

²³ Për shkak të emërimit të tyre pas vitit 2009, këta gjyqtarë nuk mund të vlerësoheshin për vitet 2005-2006 apo për vitet 2007-2009

kjo analizë nuk mund të bëhet ende në këtë moment sepse duhet pritur përfundimi i të gjithë raundit të vlerësimit për vitet 2007-2009.

Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve është marrë në analizë nga Projekti “Mbështetje për Efikasitetin në Drejtësi – SEJ”, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Në fillim të marsit 2009, SEJ publikoi Raportin²⁴ e këtij vlerësimi të hartuar nga Prof. Dr. Anne Sanders, M.Jur, i cili hedh dritë mbi avantazhet dhe disavantazhet e modelit shqiptar, përjashtuesisht me standardet evropiane, duke konkluduar me dhënien e 21 rekomandimeve. Thelbi i rekomandimeve është afrimi në kohë i rezultateve të vlerësimit dhe përmirësimi i sistemit të vlerësimit, duke qartësuar kriteret matëse dhe duke përmirësuar procesin deri tek kontrolli gjyqësor i akteve të vlerësimit. Mbi veprimtarinë e Inspektoratit, Raporti ka rekomanduar finalizimin e raundit të dytë, përdorimin e kujdesshëm të të gjithë përvojës së Inspektoratit nga ky proces, forcimin e urës lidhëse midis rezultateve të vlerësimit dhe hartimit të kurrikulave për trajnimin profesional të gjyqtarëve nga Shkolla e Magjistraturës, publikimin e udhëzimeve dhe shembujve për zbatimin e kriterëve deri tek marrjen e masave për ta shndërruar pozicionin e inspektorit në një pozicion më atraktiv.

➤ **Vlerësimi i punës së kryetarëve të gjykatave**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 9 të vendimit nr. 227/2, datë 28.03.2008 “Për funksionin drejtues në gjykata”i ndryshuar, në mbledhjen plenare të datës 17.10.2014 miratoi programin mbi përcaktimin e kryetarëve të gjykatave që do t’i nënshtrohen vlerësimit për dy vjet në detyrë duke përcaktuar se raporti përpilohet nga Kryeinspektori, i cili duhet të bazohet në këto të dhëna:

- i. raportin e të deleguarit pjesëmarrës të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në analizat vjetore të gjykatës, e veçanërisht për punën e kryetarit;
- ii. vizitat e Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykata gjatë mandatit të kryetarit;
- iii. materiale që vijnë nga Ministri i Drejtësisë;
- iv. materiale të tjera që rezultojnë nga verifikimet apo kontrollet gjatë periudhës që ai ka qenë në detyrën e kryetarit të gjykatës;
- v. aktet e nxjerra nga kryetari i gjykatës në ushtrim të kompetencave të veta të parashikuara në nenin 18 të ligjit nr. 9877 datë 18.02.2008;
- vi. aktet e nxjerra nga kryetari i gjykatës për drejtimin administrativ të gjykatës;
- vii. rezultatet e ankesave të paraqitura ndaj tyre në cilësinë e kryetarit;
- viii. Të dhëna statistikore mbi funksionimin e gjykatës në krahasim me vitet e mëparshme;
- ix. Një raport vjetor nga kryetari i gjykatës mbi menaxhimin dhe rezultatet financiare të gjykatës.
- x. Informacion nga ZABGj;
- xi. Informacion nga gjyqtarët dhe administrata gjyqësore e gjykatës;
- xii. Informacione nga dhoma vendore e avokatëve dhe drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës, ku kryetari ushtron detyrën e gjyqtarit.

²⁴ Ky raport është publikuar edhe në faqen zyrtare të KLD-së në adresën <http://kld.al/korniza-ligjore/sistemi-i-vleresimit/raport-p%C3%ABr-vler%C3%ABsimin-individual-t%C3%AB-gjyqtar%C3%ABve-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>

Me vendimin nr. 127, datë 17.10.2014 të KLD-së u miratua programi për përcaktimin e kryetarëve të gjykatave që do t'i nënshtrohen vlerësimit në detyrë. Në zbatim të këtij vendimi, gjatë vitit 2014, filloi për herë të parë, procedura për grumbullimin e materialeve të nevojshme për vlerësimin e 3 kryetarëve, konkretisht për kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, kryetarin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Për këtë qëllim, është kërkuar paraqitja në Inspektorat e informacionit të mëposhtëm:

1. Çdo akt i nxjerrë nga ana kryetari në ushtrimin e kompetencave të parashikuara nga neni 18 i ligjit nr. 9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në RSh”;
2. Çdo akt i nxjerrë nga kryetari për drejtimin administrativ të gjykatës të parashikuara në akte ligjore dhe nënligjore të KLD-së,
3. Raporti vjetor mbi menaxhimin dhe rezultatet financiare të gjykatës.

Gjithashtu, iu është kërkuar me shkrim Drejtuesve të Prokurorive, të Dhomave Vendore të Avokatisë, Kancelarëve dhe ZABGj-së informacion me shkrim mbi veprimtarinë e këtyre kryetarëve. Informacioni i mësipërm është grumbulluar në Inspektorat dhe ka filluar procesi i hartimit të raportit.

Inspektorët Hajrie Muçmata e Fatbardh Coniku janë paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe kanë proceduar me marrjen e të dhënave nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, duke përmbyllur kështu të dhënat e nevojshme për hartimin e raportit për vlerësimin e këtij Kryetari. Në këto rrethana, raporti i vlerësimit të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet është në fazën përmbyllëse nga kryeinspektorja, ndërsa procesi i vlerësimit të kryetarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është në fazën e grumbullimit të të dhënave nga gjyqtarët e gjykatave respektive.

IV. DELEGIMET E GJYQTARËVE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të neneve 1 dhe 2 shkronja f) të ligjit r.8811 datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së", i ndryshuar dhe të nenit 21 pika 2 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh", i ndryshuar, ka nxjerrë vendimin nr. 319, datë 03.05.2013 "Për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve për shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore". Me anë të këtij vendimi, IKLD është ngarkuar me përpunimin e të gjitha kërkesave, duke përgatitur relacion të detajuar dhe tabelat për çdo çështje apo grup çështjesh që i përkasin të njëjtës gjykatë, me qëllim propozimin KLD-së, për gjyqtarin/gjyqtarët konkretë të gjykatës nga ku do të kryhet delegimi në zbatim të kriterëve të delegimit. Rregullat e caktuara nga KLD reflektojnë parimet themelore të administrimit të drejtësisë, si dhe garantojnë një procedurë të qartë dhe të drejtë të delegimit të gjyqtarëve për të bërë të zbatueshëm parimin e gjyqtarit natyral. Procesi i delegimit të gjyqtarëve jep impakt në efektivitetin dhe integritetin e procedurave të caktimit të gjyqtarëve në një çështje gjyqësore, si një komponent i rëndësishëm i procesit të rregullt gjyqësor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili përbën edhe një prej të drejtave themelore më të rëndësishme të individit të sanksionuar nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë vitit 2014 janë depozituar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë gjithsej **433 kërkesa nga kryetarët respektivë të gjykatave për delegimin e 598 gjyqtarëve në 433 çështje**, me motivacionin se nuk kanë mundësi të shqyrtojnë një apo disa çështje brenda afateve të arsyeshme kohore. Këto të dhëna i përkasin kërkesave për çështje konkrete, të plotësuara sipas formularit standard që përcakton vendimi nr. 319, datë 03.05.2013 i KLD-së. Përpunimi i kërkesave është realizuar me mbështetjen e Sektorit Juridik dhe të Dokumentacionit të Drejtorisë Juridike, konkretisht nga specialistja Brunilda Çarçiu.

Nga Gjykatat e Apeleve janë paraqitur gjithsej 175 kërkesa (81 kërkesa për delegime për çështjet penale dhe 94 për çështjet civile e administrative), për delegimin e 285 gjyqtarëve në 175 çështje gjithsej. Nga Gjykatat e Shkallës së Parë janë paraqitur 258 kërkesa (179 kërkesa për delegime për çështjet penale dhe 79 për çështjet civile e administrative). Në të dhënat për gjykatat e shkallës së parë duhen shtuar 64 çështjet (20 çështje penale dhe 44 çështje civile) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për gjykimin e të cilave janë deleguar gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, si dhe 136 çështjet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për gjykimin e të cilave janë deleguar gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Gjykatat e Apelit				
Nr	Gjykata	175 Çështjet		Gjyqtarë
		Penale	Civile	
1	Apeli Durrës	-	6	17
2	Gjirokastër	27	45	95
3	Korçë	34	24	82
4	Shkodër	8	10	33
5	Tiranë			
6	Vlorë	1	8	25
7	Krimet e Rënda	11		30
8	Apeli Administrativ		1	3

Gjithsej		81	94	285
Gjykatat e Shkallës së Parë				
Nr.	Gjykata	258 Çështjet		Gjyqtarë
		Penale	Civile	
1	Berat	-	-	-
2	Dibër	24	-	26
3	Durrës	-	1	1
4	Elbasan	1	-	1
5	Fier	-	1	1
6	Gjirokastrë	-	2	2
7	Kavajë	25	2	31
8	Korçë	-	-	--
9	Krujë	1	7	9
10	Kukës	20	-	26
11	Kurbin	38	12	65
12	Lezhë	3	-	5
13	Lushnje	2	2	5
14	Mat	4	5	12
15	Përmet	2	-	2
16	Pogradec	21	6	32
17	Pukë	11	1	12
18	Sarandë	11	17	32
19	Shkodër	3	-	9
20	Tiranë	-	2	2
21	Tropojë	13	-	19
22	Vlorë	-	-	-
23	Shkalla e Parë për K.Rënda	-	-	-
24	Administrative Tiranë	-	-	-
25	Administrative Durrës	-	-	-
26	Administrative Gjirokastrë	-	3	3
27	Administrative Korçë	-	12	12
28	Administrative Tiranë	-	1	1
29	Administrative Vlorë	-	5	5
Gjithsej		179	79	313

Në shtesë të kërkesave të kryetarëve të gjykatave për delegimin e gjyqtarëve për çështje konkrete, në KLD janë paraqitur edhe kërkesa nga gjykatat administrative për delegimin në grup të gjyqtarëve për një grup çështjes, me argumentin se volumi i lartë i çështjeve në gjykatat administrative, përbënte pengesë për gjykimin e çështjeve. Konkretisht, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me shkresën nr. 390 prot, datë 01.07.2014, ka paraqitur kërkesë për të deleguar gjyqtarë për 136 çështjet (të prishura e të kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Administrativ). Kjo kërkesë është trajtuar në mbledhjen e datës 21.07.2014 dhe me vendimin nr. 108, datë 21.07.2014 janë caktuar 3 gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me shkresat e datave 16.05.2014 dhe 02.05.2014, ka paraqitur kërkesë për delegimin e 4 gjyqtarëve. Kërkesa është trajtuar në mbledhjen e datës 28.05.2014 dhe me vendimin nr. 71, date 30.05.2014 janë deleguar 4 gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilët duhet të gjykojnë secili nga 50 çështje gjyqësore.

Gjykata e Apelit Administrativ, me shkresën nr. 177 prot, datë 03.03.2014, ka paraqitur kërkesë

për delegim gjyqtarësh, kërkesë e trajtuar në mbledhjen e dates 11.04.2014. Me vendimin nr. 43, date 11.04.2014, janë deleguar dy trupa gjykues nga tre gjyqtarë, ku çdo gjyqtar duhet të gjykonte nga 50 çështje. Po kështu, nga e njëjta Gjykatë është kërkuar me shkresën nr. 342 prot, datë 05.05.2014, kërkesë për delegim gjyqtarësh, e trajtuar në mbledhjen e datës 28.05.2014. Me vendimin nr. 71, date 30.05.2014, janë deleguar 3 trupa gjykues me tre gjyqtarë, ku çdo gjyqtar duhet të gjykonte nga 50 çështje. Së fundmi, Gjykata e Apelit Administrativ, me shkresën nr. 723 prot, datë 01.09.2014, ka paraqitur kërkesë për delegimin e gjyqtarëve për gjykimin e 3700 çështjeve. Paraqitja e kësaj kërkesë i dha shkas vendimit nr. 149, datë 05.12.2014 të KLD-së për kryerjen e Studimit Vlerësues “Mbi ngarkesën e punës në Gjykatën Administrative të Apelit”. Studimi u shqyrtua dhe u miratua në mbledhjen plenare të datës 03.03.2015 të KLD-së. Ai është publikuar edhe në faqen zyrtare të KLD-së²⁵.

Në raport me vitin 2013, ka patur një rritje të kërkesave për delegimin e gjyqtarëve. Kjo rritje i atribuohet kryesisht volumit të lartë të gjykatave administrative dhe vakancave të gjyqtarëve në to. Po ashtu, ka ndikuar në shtimin e numrit të kërkesave për delegimeve, edhe situatat e veçanta në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Kurbin, Pogradec të cilat, pas riorganizimit gjyqësor kanë mbetur me 4 gjyqtarë dhe gjyqtarët kanë lëvizur prej tyre (gjyqtarët janë rekrutuar në struktura të tjera juridiko-profesionale, gjyqtarët janë larguar me leje afatgjata për studime jashtë shtetit, gjyqtari ka dalë në pension apo gjyqtari është pezulluar nga detyra për t’iu nënshtruar ndjekjes penale).

Duke analizuar këto të dhëna, mbetet ende prezente nevoja për monitorimin e kujdesshëm të procesit të delegimeve për dy arsye bazë: (i) numri i lartë i kërkesave të paraqitura shton kostot financiare të procesit gjyqësor nga njëra anë, por edhe zgjat kohën e gjykimit në dëm të palëve nga ana tjetër; (ii) numri i kërkesave për delegim nga gjykata të caktuara nxjerr në pah eficientën e organizimit gjyqësor. Në kontekstin e monitorimit të këtij procesi, duhet evidentuar se një prej faktorëve që ndikon ndjeshëm në numrin e lartë të kërkesave për delegime është edhe numri i lartë i heqjeve dorë apo përjashtimeve të gjyqtarëve nga procese konkrete. Gjithashtu, edhe për vitin 2014 mbetet shqetësimi për nevojën e një baze elektronike të dhënash për menaxhimin transparent dhe efektiv të këtij procesi që nga momenti i paraqitjes së kërkesës në KLD gjer në organizimin e shortit të gjyqtarëve për delegim.

²⁵ *Shih* <http://kld.al/korniza-ligjore/akte-n%C3%ABnligjore/studimi-mbi-ngarkesen-ne-gjykatën-administrative-te-apelit>

V. PËRFAQËSIMET NË GJYKATA

Me vendimin nr. 323, datë 0305.2013 “Mbi autorizimin e përfaqësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykatë”, KLD mbështetur në ligjin nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar autorizoi zëvendëskryetarin e KLD që të caktojë personat, të cilët do të përfaqësojnë Këshillin në gjykata.

Gjatë vitit 2014 IKLD ka ndjekur dhe ka përfaqësuar KLD në 20 çështje gjyqësore, ku vetëm në 1 rast KLD ka qenë në pozitën e kërkuarit me objekt “përjashtim gjyqtari”. Në 2 çështje gjyqësore, KLD ka qenë në cilësinë e personit të interesuar në gjykime administrative të juridiksionit fillestar në Kolegje të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa në 18 çështje gjyqësore në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Gjykatat kanë dhënë gjithsej 21 vendime gjyqësore (për 1 çështje gjatë vitit 2014 është shprehur gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit). 17 vendime gjyqësore janë dhënë në favor të KLD-së, ndërsa 4 vendime janë dhënë kundër KLD-së. Duke i krahasuar të dhënat me ato të vitit 2013 (10 çështje gjyqësore, nga të cilat 8 çështje janë fituar, ndërsa 2 janë humbur), konstatohet se ka patur dyfishim të volumit të punës në këtë proces.

Lidhur me lëndën e gjykimit më 20 çështjet gjyqësore rezulton se në 1 çështje gjyqësore, paditësi ka kërkuar të rivendoset në afat për të ushtruar ankim ndaj një vendimi të KLD-së të vitit 1996; në 1 çështje gjyqësore, gjyqtari ka kundërshtuar vendimin e KLD-së për shkarkimin e tij nga detyra; në 2 çështje gjyqësore gjyqtarët kanë kundërshtuar aktet e vlerësimit profesional dhe etik; në 3 raste, paditësat kanë kërkuar detyrimin e KLD-së për emërimin e tyre si gjyqtar; në 1 çështje gjyqësore, paditësi ka kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ për shpërblimin e dëmit; në 1 çështje gjyqësore, paditësi ka kërkuar detyrimin e KLD-së për ta emëruar atë në detyrën e inspektorit, në 1 çështje gjyqësore, paditësi ka kërkuar detyrimin e KLD-së për ti vënë në dispozicion kopje të dosjeve të procedimeve disiplinore të gjyqtarëve, në 2 raste gjykimet kanë patur për objekt përjashtimin e gjyqtarëve, në një rast paditësi ka kundërshtuar aktin e tërheqjes së vëmëndjes me shkrim nga KLD, ndërsa dhe në 7 çështje gjyqësore gjyqtarët kanë kundërshtuar vendimet e KLD-së për dhënien e masave disiplinore ndaj tyre (në 2 raste të tjera nuk ka përfunduar ende gjykimi). Të dhënat më të detajuara paraqiten si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkuarit Albano Çepele dhe personit të interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 45, datë 15.04.2013 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin e tij nga detyra”. Përfaqësimi i KLD-së është realizuar nga kryeinspektorja Marsida Xhaferllari dhe inspektorja Vojsava Osmanaj. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.4 , datë 13.10.2014 vendosën “Prishjen e vendimit nr 45, datë 15.04.2013 dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.
2. Çështja gjyqësore pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkuarës Suzana Frashëri dhe personit të interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë, me objekt “Rivendosje në afat të së drejtës së kërkuarës Suzana Frashëri për t’u ankuar kundër vendimit nr. 8, dt 23.08.1996 për shkarkimin e saj nga

detyra”. Përfaqësimi i KLD-së është realizuar nga kryeinspektorja Marsida Xhaferllari dhe inspektorja Hajrie Muçmata. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 5, datë 27.10.2014 vendosën “Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova dhe në ligj”.

3. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditëses Herila Çela kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Anullim i vendimit nr. 105, datë 21.07.2014 i KLD-së për dhënien e masës disiplinore ‘vërejtje me paralajmërim’ ndaj gjyqtarës Herila Çela”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë me shumicë votash, në përfundim të gjykimit, me vendimin gjyqësor nr. 23, datë 05.12.2014 ka vendosur “Pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. 105, dt 21.07.2014 të KLD-së”. Aktualisht kjo çështje bazuar në rekursin e KLD-së, ndodhet në pritje të gjykimit për në Gjykatë të Lartë.
4. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditësit Andri Ymeri kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 88, datë 07.07.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, në përfundim të gjykimit, me vendimin gjyqësor nr. 3, datë 29.01.2015 ka vendosur “Pranimin pjesërisht të padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. 88, dt 07.07.2014 të KLD-së”. Aktualisht kjo çështje bazuar në rekursin e KLD-së, ndodhet në pritje të gjykimit për në Gjykatë të Lartë.
5. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditëses Engjëllushe Tahiri kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 48, datë 15.04.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorja Hajrie Muçmata dhe Marsela Pepi. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, në përfundim të gjykimit, me vendimin gjyqësor nr. 38, datë 07.07.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë”. Aktualisht kjo çështje bazuar në rekursin e paditëses, ndodhet në pritje të gjykimit për në Gjykatë të Lartë.
6. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditëses Nazmie Pengili kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 47, datë 15.04.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, në përfundim të gjykimit, me vendimin gjyqësor nr. 8, datë 30.06.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Aktualisht kjo çështje bazuar në rekursin e paditëses, ndodhet në pritje të gjykimit për në Gjykatë të Lartë.
7. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditëses Enkeleda Hoxha kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 46, datë 15.04.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorët

Vojsava Osmanaj dhe Izet Salaj. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, në përfundim të gjykimit, me vendimin gjyqësor nr. 10, datë 15.07.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Aktualisht kjo çështje bazuar në rekursin e paditëses, ndodhet në pritje të gjykimit për në Gjykatë të Lartë.

8. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditëses Lindita Hoxha kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Anullim i vendimit nr. 62, datë 28.05.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “vërejtje”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, në përfundim të gjykimit të kësaj padie me vendimin gjyqësor nr. 21, datë 24.11.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë”. Aktualisht kjo çështje bazuar në rekursin e paditëses, ndodhet në pritje të gjykimit për në Gjykatë të Lartë.
9. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditëses Elona Gjoka kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 44, datë 15.04.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “transferim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për 2 vjet”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Izet Salaj. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, në përfundim të gjykimit, me vendimin gjyqësor nr. 15, datë 30.09.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj”. Aktualisht kjo çështje bazuar në rekursin e paditëses, ndodhet në pritje të gjykimit për në Gjykatë të Lartë.
10. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditësit Agron Lamaj kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Shfuqizim i vendimit nr. 302, datë 20.12.2012 (pikat a dhe b), si dhe ai i dt.05.07.2013 të KLD-së (emërimi i gjyqtarëve të apelit), si akte të paligjshme në kundërshtim me parimet e procedurës së administratës publike, konstatimi i diskriminimit i interesave dhe të drejtave themelore dhe detyrimi i palës së paditur të marrë vendim për emërimin tim si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 7179, datë 09.12.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë për gjykim, bazuar në apelin e paditësit.
11. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditësit Qendra “Res Publica” kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Detyrimin e të paditurit të japë informacion dhe dokumenta zyrtare në lidhje dosjet e shqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve për vitin 2014 etj”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 6723, datë 20.11.2014 ka vendosur “Pushimin e gjykimit për shkak të heqjes dorë”.
12. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditësit gjyqtar Rasim Doda, kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt

“Ndryshim i vendimit nr 93/2 dt.07.07.2014 të të paditurit përse i përket vlerësimit “Mirë” për gjyqtarin dhe të vendoset vlerësimi “Shumë Mirë”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr.7053, datë 02.12.2014 ka vendosur “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Aktualisht, kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për gjykim, bazuar në ankimin e paditësit.

13. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditëses Ina Rama, kundër të paditurve Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Presidenti i Republikës, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 16 dt 24.02.2014 i KLD-së. Detyrimin e palës së paditur të emërojë paditësen në detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, detyrim për shpërblim dëmi moral etj”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga inspektorët Vojsava Osmanaj, Izet Salaj dhe Hajrie Muçmata. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 4038, datë.14.07.2014 ka vendosur “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për gjykim, bazuar në ankimin e paditëses.
14. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket kërkues Këshilli i Lartë i Drejtësisë, persona të tretë, Ina Rama, Presidenti i Republikës, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Përjashtimi i gjyqtares Enerjeta Shehaj nga gjykimi i çështjes civile me palë ndërgjyqëse, paditës Ina Rama, i padituri KLD etj”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Hajrie Muçmata. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr.2109 datë 05.05.2014 ka vendosur “Pranimin e kërkesës”.
15. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket kërkues Ina Rama, persona të tretë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Presidenti i Republikës, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Përjashtimi i gjyqtarit Emiljano Ruli nga gjykimi i çështjes civile me palë ndërgjyqëse, paditës Ina Rama, i padituri KLD etj”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Hajrie Muçmata. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 19, datë 27.05.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës”.
16. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditësit Altin Shkurti, kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr 1203/3 prot, dt 18.10.2013 ‘Tërheqje vëmendje’ dhe shfuqizimin, anulimin e tij”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga inspektorët Marsela Pepi dhe Vojsava Osmanaj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 911, datë 07.03.2014 ka vendosur “Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj”. Mbi apelin e paditësit Altin Shkurti, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, me vendimin nr 9, dt 19.01.2015 ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. 911, dt 07.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e çështjes”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në pritje të gjykimit për në Gjykatën e Lartë, bazuar në rekursin e paditësit dhe kundër rekursin e KLD-së.

17. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditësit Kirov Babliku, kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të kryejë veprimin administrativ, duke shqyrtimin dhe miratuar kërkesën time për emërimin si inspektor pranë KLD-së”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr.2132, datë 06.05.2014 ka vendosur: “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”.
18. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditësit Kreshnik Spahiu kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Shfuqizim akti administrativ për shpërblimin e dëmit”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Sofia Zhilla. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë në përfundim të gjykimit me vendimin gjyqësor nr. 2056, datë 26.05.2014 ka vendosur “Prishjen e vendimit nr 7901 dt 09.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes”.
19. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që i përket paditësit gjyqtar Bujar Musta kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Ndryshim i pikës 18 të vendimit nr. 282, dt. 16.12.2011 të të paditurit dhe të vendoset vlerësimi Shumë Mirë për vitet 2005-2006”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Sofia Zhilla. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 620, datë 11.03.2014 ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr 4112 dt 17.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.
20. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditëses Dëshira Subashi kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, person i tretë Ministria e Drejtësisë dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të marrë në shqyrtim kërkesën e palës paditëse dhe detyrimin e saj për të emëruar paditësen në detyrën e gjyqtarës të Gjykatës së Apelit Tiranë, shpërblim dëmi moral etj”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektorja Zhaneta Pira. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 7462, datë 17.12.2014 ka vendosur “Pranimin e pjesshëm të padisë, detyrimin e palës së paditur KLD të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses etj”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë për gjykim, bazuar në apelin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të palës paditëse.

Së fundmi, duhet evidentuar se gjatë vitit 2014, në Gjykatën e Apelit Tiranë kanë depozituar kërkesë padi dhe gjyqtarët Ilir Pashaj dhe Bujar Musta të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku kundërshtojnë vendimet përkatëse të KLD-së për vendosjen e masave disiplinore ndaj tyre ‘vërejtje me paralajmërim’. Autorizimi për këto gjykime është marrë nga inspektorja Vojsava Osmanaj. Duke qënë se Gjykata e Apelit Tiranë nuk është kompetente për shqyrtimin e këtyre padive, është marrë pjesë vetëm në një seancë gjyqësore dhe është paraqitur ky pretendim me shkrim para kësaj gjykate, duke pritur njoftimin nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për të realizuar dhe përfaqësimin e plotë ligjor.

VI. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA

- *Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë*

IKLD, gjatë vitit 2014 ka vijuar bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë në drejtim të evidentimit të rasteve për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Instrumenti kryesor për zhvillimin e këtij bashkëpunimi ka qenë Memorandumi i Mirëkuptimit 2012 “Për shmangien e mbivendosjes së kompetencave në inspektimin gjyqësor”. Për këtë çështje, Raporti i Progresit i vitit 2014 thekson “lidhur me përgjegjshmërinë e gjyqësorit, memorandumi i mirëkuptimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi inspektimeve është zbatuar pa probleme. Megjithatë, mbetet rreziku i mbivendosjes së inspektimeve”²⁶.

Në bazë të këtij Memorandumi, nga Ministria e Drejtësisë, gjatë vitit 2014 kanë ardhur për kompetencë pranë IKLD 86 ankesa, të cilat janë trajtuar dhe për çdo rast Ministria e Drejtësisë është vënë në dijeni. Nga ana tjetër, IKLD ka përcjellë drejt Ministrisë së Drejtësisë shqyrtimin e 28 ankesave. Duke i krahasuar këto të dhëna me vitin 2013 (29 ankesa të paraqitura nga MD në IKLD dhe 28 ankesa nga IKLD në MD), konstatohet se është rritur numri i rasteve të referuara nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa numri i referuar nga IKLD tek Ministria e Drejtësisë ka mbetur i pandryshuar. Numri i qëndrueshëm i rasteve të referuara nga IKLD tek Ministria e Drejtësisë shpjegohet me faktin se edhe numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IKLD ka mbetur i pandryshuar – 883 ankesa²⁷. Në përcjelljen e 28 ankesave në Ministrinë e Drejtësisë është mbajtur në konsideratë lënda e ankesës në dy aspekte: (i) kur ankesa përmbante pretendime edhe për operatorë të tjerë të sistemit të drejtësisë (noterë, përmbarues, regjistruar të pasurive të paluajtshme etj); dhe/ose (ii) kur të dhënat tregonin se Ministria e Drejtësisë kishte filluar verifikimin e ankesës për shkak të paraqitjes më parë të saj tek ky institucion.

Gjithashtu, duhet evidentuar se çdo muaj IKLD ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë në format elektronik informacion statistikor mbi ankesat e paraqitura. Ky informacion i shërben identifikimit të rasteve të filluara për verifikim nga një prej strukturave inspektuese dhe rrjedhimisht, shmangien e dublimit të verifikimit.

Së fundmi, Manuali i Inspektimeve, i hartuar dhe i publikuar bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, është përdorur gjerësisht nga inspektorët. Ai përbën një mjet të mirë njohës me praktikatat e mira të inspektimit, sidomos për inspektorët e saporekrutuar në detyrë. Nga ana tjetër, në çdo rast të inspektimit tematik është urdhëruar mbajtja në referencë e këtij Manuali në zhvillimin e inspektimit dhe në hartimin e raporteve.

- *Bashkëpunimi me institucione të tjera*

Gjatë vitit 2014, IKLD është përpjekur të bashkëpunojë me Prokurorinë e Përgjithshme, duke relatuar pranë këtij institucioni jo vetëm ankesat mbi prokurorët, por edhe rastet, në të cilat ankuesit parashtronin fakte për veprime korruptive të gjyqtarëve (gjithsej 13 raste). Po ashtu edhe nga ana e këtij institucioni, janë paraqitur për kompetencë trajtimi 5 raste ankesash, që lidheshin me veprimtarinë e gjyqtarëve. Në 1 prej këtyre rasteve të verifikuara, materialet i janë

²⁶ *Shih* Raportin e Progresit për Shqipërinë 2014, faqe 41

²⁷ *Shih* Rubrikën Verifikimi i Ankesave të këtij Raporti, faqe 7-13

përcjellë Ministrin të Drejtësisë për procedim disiplinor. IKLD vlerëson se ka nevojë për përmirësimin e këtij bashkëpunimi nëpërmjet krijimit të regjistrave solidë mbi këtë bashkëpunim dhe ndjekjen e rezultateve në vijimësi.

IKLD, gjatë vitit 2014, në 2 raste ankesash ka bashkëpunuar me ILDKP për verifikimin e pretendimeve të ankuesve mbi çështje të pasurisë së dy gjyqtarëve. Një prej këtyre rasteve është përcjellë nga IKLD në ILDKP, ndërsa rasti tjetër është përcjellë nga ILDKP në IKLD. Në këtë rast të fundit, është kërkuar mendim edhe nga Komisioni i Etikës i Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe ende nuk ka një rezultat përfundimtar. Në vlerësimin e IKLD-së, edhe në këtë drejtim duhet të rritet niveli i bashkëpunimit.

Në vitin 2014 ka patur rritje të nivelit të bashkëpunimit me Komisionin e Etikës të Konferencës Gjyqësore Kombëtare, me të cilin është synuar të krijohet një marrëdhënie e shëndoshë bashkëpunimi. Inspektorati i ka përcjellë 5 raste Komisionit të Etikës të Konferencës Gjyqësore Kombëtare, i cili përbëhet vetëm nga gjyqtarë të të gjitha niveleve, për marrje mendimi këshillimor, nëse sjellja e konstatuar ka qenë në përputhje me rregullat e Kodit të Etikës. Në çdo rast të referuar, Komisioni i Etikës është përgjigjur me opinion këshillimor me shkrim të arsyetuar. Ky lloj bashkëpunimi institucional është shumë i vlefshëm sepse i shërben qasjes proaktive dhe të shumëfishtë institucionale në parandalimin e sjelljeve që cenojnë integritetin e gjyqtarëve. Nga ana tjetër, ky bashkëpunim rrit në mënyrë të ndjeshme reagimin nga radhët brenda gjyqësorit.

IKLD ka marrë pjesë edhe në zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit datë 12.02.2013 të lidhur midis Ministrisë së Drejtësisë, KLD-së dhe Avokatit të Popullit “Për referimin e rasteve dhe masave administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë kur konstatohet shkelje të ligjit”. Në zbatim të këtij memorandumi, Avokati i Popullit ka referuar 9 raste ankesash. Rezultatet e këtyre ankesave janë paraqitur tek rubrika e verifikimit të ankesave²⁸.

- *Të tjera*

Gjatë vitit 2014, IKLD ka vijuar të asistohet nga partnerët ndërkombëtarë. Fillimi i zbatimit të projektit të Misionit Euralius IV, i financuar nga Bashkimi Evropian, vlerësohet të jetë një përparësi në përmirësimin e cilësisë së standardeve të punës. Në ambientet e KLD-së është vendosur me zyrë ekspertja ndërkombëtare Agnes Bernhard, që lehtëson komunikimin dhe procesin e bashkëpunimit. Me asistencën e këtij Misioni, po punohet për të finalizuar për herë të parë Skema e Vlerësimit të Inspektorëve. Gjithashtu, me ndërmjetësimin e këtij Misioni është mundësuar ngritja e një grupi të zgjeruar pune për hartimin e projektligjit të ri për vlerësimin profesional të gjyqtarëve.

Projekti “Mbështetje për Sistemin e Drejtësisë – SEJ” i bashkëfinancuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian gjatë vitit 2014 ka vijuar me disa aktivitete të orientuara për të rritur efikasitetin në gjykata. Në këtë pikëpamje, janë analizuar treguesit statistikorë të gjykatave, është analizuar sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve, janë zhvilluar aktivitete trajnuese mbi statistikat dhe efikasitetin dhe po punohet për të sonduar për herë të parë përshtypjet e përdoruesve të

²⁸ *Shih* faqen 13 të këtij Raporti

drejtpërdrejtë të gjykatave. Nga Inspektorati i është dhënë mbështetje këtij projekti, qoftë në formën e konsultimit dhe sugjerimeve në hartimin e raporteve bazë të tyre, qoftë edhe me pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese.

Ka vijuar bashkëpunimi me Prezencën e OSBE-së në Tiranë për të rritur edukimin ligjor të qytetarëve mbi funksionet e Inspektoratit, si dhe për trajnimin e inspektorëve. Për këtë qëllim janë hartuar dhe shpërndarë broshura informative, si dhe po punohet edhe për përmirësimin e informacionit në faqen zyrtare të KLD-së, sidomos në drejtim të sistemit elektronik të menaxhimit të ankesave.

Prezenca e OSBE-së dhe JuST USAID, gjatë vitit 2014 kanë vijuar të zbatojnë në gjykatat e rrethve gjyqësore Krujë dhe Korçë projektin “Për një drejtësi pa vonesa”. Po ashtu, JuST USAID, sipas një kalendari të mirëpërcaktuar ka vijuar me implementimin e sistemit të regjistrimit audio nëpër gjykata. Inspektorati është përfshirë në aktivitete trajnimi mbi teknikat e reja të përdorura dhe treguesit e këtyre projekteve, me qëllim monitorimin e veprimtarisë gjyqësore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2014, IKLD ka përfituar asistencë edhe nga Ambasada Franceze dhe Misioni OPDAT në formën e aktiviteteve trajnuese të dedikuara posaçërisht për inspektorët mbi etikën. Në këtë mënyrë është mbuluar problematika e mungesës së një skeme të qartë trajnimi për inspektorët.

IKLD gjatë vitit 2014 është ngarkuar edhe me përpunimin e informacionit në funksion të raportimeve të ndryshme në procesin e integritetit europian apo të raportimeve të Republikës së Shqipërisë në organizata ndërkombëtare.

Kryeinspektore

Marsida Xhaferllari